



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURRENCËS

RAPORTI VJETOR 2009

DHE

SYNIMET KRYESORE PËR VITIN 2010

**Autoriteti i Konkurrencës**

Adresa: Rr. Sami Frashëri, nr. 4, Kati IV, Tiranë

Tel: +355 4 2 234 504

Fax: +355 4 2 234 497

Faqe e internetit: [www.caa.gov.al](http://www.caa.gov.al)

Email: [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)

## PËRMBAJTJA

<b>Fjala e hyrjes .....</b>	<b>3</b>
<b>I. Parimet bazë të funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës dhe zhvillimet kryesore ....</b>	<b>5</b>
I.1. Misioni, vizioni dhe objektivat .....	5
I.2. Zhvillimet kryesore të aktivitetit.....	5
<b>II. Struktura organizative dhe forcimi i kapaciteteve administrative .....</b>	<b>9</b>
II.1. Struktura organizative .....	9
II.2. Forcimi i kapaciteteve administrative.....	11
<b>III. Aktiviteti i Autoritetit në zbatim të tre shtyllave kryesore të ligjit të konkurrencës.....</b>	<b>13</b>
III.1 Marrëveshjet e ndaluara.....	13
III.2. Abuzimi me pozitën dominuese.....	16
III.3 Kontrolli i Përqëndrimeve .....	17
III.4 Monitorimet.....	21
<b>IV. Advokatia e konkurrencës .....</b>	<b>24</b>
IV.1 Rekomandime mbi projektet e akteve normative.....	24
IV.2 Rekomandime mbi aktet normative.....	24
IV.3 Hartimi dhe miratimi i kuadrit nënligjor.....	26
IV.4 Rishikimi gjyqësor i çështjeve të Autoritetit të Konkurrencës.....	28
<b>V. Kultura e konkurrencës .....</b>	<b>31</b>
<b>VI. Bashkëpunimi me institucionet, entet rregullatorë dhe organizmat ndërkombëtare .</b>	<b>33</b>
VI.1. Bashkëpunimi me entet rregullatorë dhe institucionet e tjera .....	33
VI.2 Bashkëpunimi me Bashkimin Europian (dhe TAIEX).....	34
VI.3 Rrjeti rajonal i konkurrencës.....	35
VI.4 Bashkëpunimi me qendrën rajonale OECD .....	36
<b>VII. Realizimi i buxhetit të Autoritetit të Konkurrencës .....</b>	<b>37</b>
<b>VIII. Synimet kryesore të punës për vitin 2010 .....</b>	<b>38</b>
VIII.1 Forcimi i advokatisë dhe i kulturës të konkurrencës .....	38
VIII.2. Forcimi i kapaciteteve administrative .....	39
VIII.3. Monitorimi i tregjeve dhe hetimi i praktikave të mundshme antikonkurrense.....	39
VIII.4. Konsolidimi i profilit të bashkëpunimit të AK me partnerët ndërkombëtare.....	40
Shtojcë 1. Të dhëna statistikore mbi vendimet e KK sipas viteve .....	41
Shtojcë 2: Vendimet administrative(gjobat) e vendosura nga KK .....	42
Shtojcë 3: Matrica e vlerësimeve dhe rekomandimeve të AK për vitin 2009.....	43
Shtojcë 4: Raport progresi i KE për Shqipërinë për vitin 2009 (Konkurrenca) .....	48

## **Fjala e hyrjes**

Kryetar i Autoritetit të Konkurrencës  
Lindita Milo(Lati), Ph.D.

Pohimi që evidentohet në të gjitha politikat aktuale ekonomike të vëndeve të zhvilluara është se një politikë e qartë dhe e qëndrueshme për nxitjen e konkurrencës do të mundësojë rigjallërimin ekonomik, pasi përbën çelësin e produktivitetit dhe të rritjes.

Autoriteti i Konkurrencës ka ndjekur me kujdes zhvillimet kryesore të tregjeve në vend; ka nxjerre mësim nga zhvillimet në vendet e tjera për një rol më aktiv në nxitjen e konkurrencës nëpërmjet ndërhyrjes së drejtpërdrejtë për të ndëshkuar fenomenet antikonkurrese, përmes forcimit të advokatisë së ligjit dhe të politikës kombëtare të konkurrencës, si dhe rritjes së kulturës së komunitetit të biznesit, të institucioneve publike, të mediave të shkruara dhe elektronike, si dhe publikut të gjërë.

Autoriteti i Konkurrencës ka konsoliduar profilin si një institucion që punon për të arritur standardet jo vetëm duke përmirësuar kapacitetet institucionale për të rritur efikasitetin e ndërhyrjeve në tregjet e prekura, por për të mundësuar një bashkëpunim real me operatorët e tregut, institucionet qëndrore dhe entet rregullatore, të cilët janë konsideruar si faktorë shumë të rëndësishëm për të mundësuar një treg funksional.

Ky fakt shprehet nga llojshmëria e tregjeve të monitoruar dhe të hetuar, nga rritja e ankesave të biznesit, nga përsosja e teknikave investigative, apo nga vlerësimet e partnerëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Progres Raporti i Komisionit European për Shqipërinë konstaton se Autoriteti i Konkurrencës ka patur progres të mirë.

Eksperiencia mbi pesëvjeçare tregon se efikasiteti i zbatimit të Ligjit dhe Politikës së Konkurrencës është e lidhur ngushtë me harmonizimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor që ndikon drejtpërdrejtë apo jo në funksionimin e tregjeve me filozofinë e promovimit të konkurrencës. Rritja e mirëqënies ekonomike të operatorëve të tregut dhe të konsumatorit final kërkon një bashkëpunim proaktiv të komunitetit të biznesit, enteve rregullatore të tregjeve specifike, Autoritetit të Konkurrencës dhe politikbërësve, si faktor që mundësojnë rritjen reale ekonomike

Sfidat e së ardhmes shtrojnë si domosdoshmëri rritjen e advokatisë nëpërmjet rritjes së transparencës, bashkëtrajnitimit dhe zgjerimit të tryezave konsultative me të gjithë

aktorët dhe faktorët e tregut, me synimin e krijimit të një formacioni të përbashkët për të parandaluar dhe penguar praktikant antikonkurrese. Në këtë mënyrë institucioni i konkurrencës synon të ulë risqet dhe kostot e fenomeneve ekonomike para se ato të bëhen fakt dhe të kthehen në çështje për zbatimin e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pra të shoqërohen me praktika antikonkurrese.

Autoriteti shqiptar i Konkurrencës konsiderohet si një eksperiencë interesante për rritimin e rritjes nga partnerët tanë ndërkombëtarë, cilësi që kërkon rritjen e përgjegjshmërisë dhe të profesionalizmit në përmbushjen e standarteve të integritimit në zbatim të Ligjit dhe të Politikës Kombëtare të Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës është një e mirë publike e shtetit shqiptar që mbron konkurrencën efektive në treg duke patur si qëllim final rritjen e mirëqënies së konsumatorit.

## **I. Parimet bazë të funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës dhe zhvillimet kryesore**

Autoritetin e Konkurrencës funksionon në zbatim të Ligji 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar nga Ligji nr 9499 datë 3.04.2006) dhe të Politikës Kombëtare të Konkurrencës. Normat dhe parimet e veprimtarisë së Autoritetit e kanë burimin në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në të drejtën europiane të konkurrencës, në traditën më të mirë administrative të krijuar ndër vite, si dhe në praktikat më të mira të autoriteteve homologe të vendeve të tjera me të cilat bashkëpunojmë dhe shkëmbejmë eksperiencat respektive.

### ***1.1. Misioni, vizioni dhe objektivat***

Autoriteti i Konkurrencës e ushtron veprimtarinë e tij si një institucion publik, i pavarur, me mision mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive për një treg sa më funksional, me synimin final realizimin e përfitimeve sa më të mëdha të mundshme për konsumatorët .

Realizimi i këtij misioni është mundësuar nëpërmjet veprimit sipas vizionit të Komisionit të Konkurrencës i cili konsiston në vlerësimin në mënyrë sa më objektive të sjelljes së operatorëve në treg dhe të efekteve të akteve normative në funksionimin e tregut. Gjithashtu realizimi i këtij misioni mbeshtetet në praktikat më të mira të eksperiencës europiane e më gjerë, si dhe në specifikavet e ekonomisë shqipëtare si: madhësia e tregut, masa e informalitetit, etj.

Ky vizion është konkretizuar nëpërmjet përcaktimit të objektivave të cilat janë realizuar nëpërmjet një diskutimi gjithëpërfshirës të strukturës së Autoritetit të Konkurrencës. Këto objektiva janë : krijimi i një stafi të kualifikuar me njohuri të thella në fushën e ekonomisë dhe të së drejtës, që të jetë i aftë të aplikojë metodologji, të kryejë studime dhe të realizojë investigime në terren në zbatim të ligjit; sigurimi i një transparence të plotë në procedurat e ndjekura të vendimmarrjes dhe të zbatimit të detyrave të tij funksionale; bashkëpunimi i ngushtë me entet rregullatore, institucionet qendrore e vendore dhe autoritetet gjyqësore; udheheqja nga parimet e drejtësisë, të barazisë dhe paanshmerisë në zbatimin e detyrave të tij funksionale.

### ***1.2. Zhvillimet kryesore të aktivitetit***

Raporti i progresit i Komisionit Evropian për vitin 2009 cilëson se “Progres i mirë është arritur në fushën e konkurrencës”, duke përbërë një hop cilesor në vlerësimin e aktivitetit të Autoritetit të Konkurrencës në 6 vitet e funksionimit të tij. Autoriteti i Konkurrencës e konsideron këtë vlerësim si një nxitje për rritjen e rasteve të nderhyrjeve në treg në mbrojtje të konkurrencës .

Viti 2009 ka shënuar një rritje të rasteve të hetuara nga Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Gjatë këtij viti AK ka aplikuar një platforme më atraktive për të rritur ndjeshmërinë e komunitetit të biznesit për një bashkëpunim më real me Autoritetin në funksion të respektimit të rregullave të ekonomisë së lirë të tregut nga të gjithë operatorët. Kjo taktikë ka çuar në rritjen e numrit të ankesave nga operatorët e tregut dhe konsumatorët në tregjet e komunikimit elektronik (2 raste), tregu farmaceutik, tregu i energjisë, tregu i profesioneve të lira si dhe tregu i sigurimeve.

Çështjet kryesore të shqyrtuara gjatë vitit 2009 nga Autoriteti i Konkurrencës lidhen me praktikën e bashkërenduara për fiksimin e çmimeve dhe marrëveshjet për ndarjen e tregut; sjelljen e ndërmarrjeve me pozitë dominuese në treg dhe në mënyrë të veçantë abuzimin me këtë pozitë; kontrollin e përqëndrimeve dhe vlerësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor që vepron në tregjet e monitoruara apo të investiguara; si dhe në vlerësimin e akt-drafteve të adresuara për opinion pranë institucionit tone. Në tërësinë e tij ky aktivitet shumëdimensional i institucionit të konkurrencës është sintetizuar në 36 vendimemarrje të Komisionit të Konkurrencës gjatë vitit të kaluar.

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2009 ka përfunduar monitorimet dhe hetimet e mbartura nga viti 2008 : në tregun e tranzitimit dhe interkoneksionit në komunikimet elektronike ; tregun e importit dhe të shitjes me shumicë të karburanteve; tregun e importit të grurit dhe të prodhimit të miellit për bukë; tregun e sigurimit të detyrueshëm TPL e brendshme. Gjithashtu janë realizuar monitorime dhe hetime në tregje të tjera : tregu farmaceutik; tregu i profesioneve të lira; tregu i menaxhimit të së drejtës së autorit; tregu i depozitave dhe i kredive; tregu i prodhimit në vend të hidrokarbureve; tregu i prokurimeve të makinave të reja. Në këtë eksperiencë të akumuluar gjatë vitit që shkoi është për t’u shënuar rritja e profesionalizimit në realizimin e investigimeve dhe të inspektimeve duke synuar uljen e kohës së realizimit të një hetimi.

Një risi për vitin 2009 ishte bashkëpunimi me QKR për nisjen e procedurave të kontrollit të përqëndrimeve me nismën e vetë Autoritetit të Konkurrencës. Rrjedhoje e këtij bashkëpunimi është realizimi i vlerësimit të transaksioneve të ndodhura në tregje të ndryshme duke analizuar ato transaksione të cilat përbënin objekt vlerësimi dhe autorizimi sipas ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” (rasti i përqëndrimit të realizuar mes Advanced Construction Group Shpk dhe Albania Airlines Mak Shpk). Gjatë vitit 2009, Komisioni i Konkurrencës ka autorizuar shtatë transaksione të shitblerjes të aksioneve, të cilat përfshijnë kryesisht sektorin financiar (bankat dhe shoqëritë e sigurimit), energjinë elektrike(OSSH-Cez sa), ndërtimi, shërbimin e internetit. Përqëndrimet e realizuara kanë qenë në formën e ndryshimit të kontrollit dhe nuk kanë paraqitur probleme të krijimit apo të forcimit të pozitës dominuese dhe për këtë arsye janë autorizuar .

Realizimi i advokacisë së ligjit dhe politikës kombëtare të konkurrencës është konsideruar si një pjesë po aq e rëndësishme për të siguruar një efekt real në treg të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës. Meqenese shkalla e zbatimit të ligjit në

këtë aspekt, ka efekt të drejtëpërdrejtë në shkallën e lirisë së tregut, kërkohet domosdoshmërisht bashkëpunimi i ngushtë veçanërisht nga ana e enteve rregullatore por edhe të institucioneve të tjera publike me autoritetin. Në këtë kontekst, autoriteti ka patur një bashkëpunim me përfitim të ndërsjelltë me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe shërbimit Postar (AKEP) duke mundësuar dhënien e rekomandimeve bazuar në analizat e entit rregullator për tregun e telefonisë së lëvizëshme dhe të telefonisë fikse., Nje bashkëpunim i tille eshte realizuar dhe me Entin Regullator të Energjisë (ERE) në përgjigje të ftesës për pjesëmarrje në tryezën e rrumbullakët te organizuar me palët e interesit para marrjes se vendimit nga ERE në lidhje me aplikimin për tarifën e reja të energjisë elektrike për vitin 2010 nga KESH sh.a, OST sh.a dhe OSSH sh.a.Per sa i perket ketij aspekti te zbatimit të ligjit, Komisioni i Konkurrencës ka marrë 10 vendime qe permbajne rekomandime te drejtperdrejta qe janë gjykuar se duhet të merren në konsideratë nga entet rregullatore apo institucionet e tjera publike sepse ndikojne në mënyrë të drejtëpërdrejtë për një treg sa më funksional. Megjithatë duhet nënvizuar se zbatimi i detyrimit ligjor nga ana e enteve rregullatore dhe institucioneve publike nuk është në atë masë që të ketë një ndikim të ndjeshëm në mirëfunksionimin e te gjitha tregjeve. Vlerësimet e kuadrit ligjor dhe rregullator dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse në rastet e kufizimit të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg janë ndërmarrë kryesisht me nismën e vetë Autoritetit të Konkurrencës.

Ky vit shënon konfirmimin nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Qarkut Tiranë të vendimeve të komisionit për dy kompanitë celulare të penalizuara për abuzimin me pozitën dominuese duke krijuar në këtë mënyrë rastet e para gjyqësore shqipëtare të së drejtës së konkurrencës.

Një aspekt tjetër i veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës është përsosja e instrumentave ligjore dhe nënligjore duke reflektuar eksperiencën në zbatim të ligjit, jo si një qëllim në vetvete, por si pjesë e komunikimit dhe e forcimit të kulturës, ndërgjegjësimit dhe advokacisë së konkurrencës me të gjithë aktorët e tregut. Në mënyrë të veçantë vendosja në funksionim të rregullores së llogaritjes së gjobave dhe lehtësimi prej tyre, për marrëveshjet e ndërmarrjeve me rendësi të vogël; përgatitja e udhëzimit të vlerësimit të përqendrimeve horizontale dhe jo-horizontale; përsosja e procedurave të brendshme të funksionimit të autoritetit për pranimin dhe trajtimin e ankesave nga operatorët e tregut apo konsumatorët apo konsolidimi i transparencës së mendimit ndryshe midis organit vendimmarrës etj., shprehin shkallën e konsolidimit të institucionit të konkurrencës.

Realizimi i advokatisë nuk mund të kuptohet pa një platformë veprimi për rritjen e kulturës së konkurrencës jo vetëm tek komuniteti i biznesit, por edhe tek komuniteti i juristëve apo i gjykatësve, si dhe tek stafet e administratës publike të institucioneve qëndrore. Kjo është arritur duke përdorur instrumentet e seminareve apo workshopeve të organizuara nga TAIEX apo OECD-Qendra rajonale e konkurrencës në Hungari, tryezave të rrumbullakta për tërheqjen e opinioneve për aktet ligjore dhe nënligjore të Autoritetit të Konkurrencës të financuar nga GTZ-ja apo me burimet e buxhetit. Në këtë kontekst, Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit të kaluar organizoi

konferencën ndërkombëtare për ditën e konkurrencës, si dhe Komisioni i Konkurrencës i rekomandoi qeverisë që të shpallë datën 3 Mars “Ditën Kombëtare të Konkurrencës” si dita e promovimit të konkurrencës ne Republikën e Shqipërisë



## **II. Struktura organizative dhe forcimi i kapaciteteve administrative**

Autoriteti i Konkurrencës e realizon aktivitetin e tij nëpërmjet veprimtarisë së 34 punonjësve, nga të cilët 20 persona janë staf teknik i përbërë nga ekonomistë dhe juristë (11 ekonomistë dhe 9 juristë). Filozofia e manaxhimit të burimeve njëzore është bazuar në rritjen e shkallës së ekspertizës së këtij stafi duke konsideruar investim trajnimin e tyre. Ky përbën një faktor përcaktues në shkallën e pavarësisë së funksionimit të institucionit. Aktualisht 10 veta nga stafi teknik kanë kryer studimet pasuniversitare të nivelit të masterit dhe 3 te tjerë janë në proces.

### **II.1. Struktura organizative**

Struktura e Autoritetit të Konkurrencës ka mbetur e pandryshuar gjatë vitit 2009 dhe paraqitet sipas Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë Nr. 182 datë 12.05.2008. Duke synuar motivimin dhe mbrojtjen e nëpunësve të Autoritetit të Konkurrencës që merren në mënyrë të drejtpërdrejtë me investigimin e tregjeve, si dhe në përputhje me nenin 27 pika 3 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.442 të datës 27.4.2009, ka ndryshuar emërtesa nga specialistë në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Tregut dhe në Sektorin e Hetimit dhe Çështjeve Juridike në inspektor. Ky ndryshim është bërë me kërkesën e Autoritetit të Konkurrencës për 8 nëpunës.

Autoriteti i Konkurrencës përbëhet nga Komisioni i Konkurrencës, si organ vendimmarrës, dhe Sekretariati si organ administrativ dhe hetimor.

Në aneksin Nr.2 është vendosur organigrama e Autoritetit të Konkurrencës.

#### **II.1.1 Komisioni i Konkurrencës**

Komisioni i Konkurrencës si organ kolegjal ka ushtruar funksionin e tij vendimmarrës në praktikën e hetuara mbi kufizimet e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Gjatë vitit 2009 kanë ndodhur dy ndryshime në Komisionin e Konkurrencës; mbarimi i mandatit të njërit nga antarët e Komisionit dhe zgjedhja nga Kuvendi i antarit të ri të Komisionit propozuar nga Presidenti i Republikës. Komisioni i Konkurrencës aktualisht përbëhet prej katër anëtarësh nga pesë që duhet të jenë në përbërjen e tij sipas Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar me ligjin 9499, datë 03.04.2006).

Pavarësia, objektiviteti dhe përgjegjshmëria kanë qenë karakteristikat bazë të aktivitetit dhe të vendimmarrjes së Komisionit të Konkurrencës edhe gjatë vitit 2009, i cili mund të konsiderohet si viti i debatit.

## **II.1.2 Sekretariati**

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës është organi administrativ i ngarkuar me ligj për të kryer monitorimin dhe hetimin për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në treg. Sekretariati përbëhet nga tre drejtori dhe sektori i analizës. Sekretariati monitoron kushtet e tregut, kryen hetime administrative dhe harton raporte mbi hetimet, të cilat paraqiten pranë Komisionit të Konkurrencës për vendimmarrje.

### **II.1.2.1 Drejtoria Mbikqyrjes së Tregut**

Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut realizon procesin e mbikëqyrjes së sjelljes së ndërmarrjeve në treg në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Politikës Kombëtare të Konkurrencës. Kjo drejtori përbëhet nga tre sektorë të emërtuar sipas tre shtyllave kryesore që prezantohen në ligj, pra sektori i abuzimit me pozitën dominuese, sektori anti-kartel dhe sektori i përqëndrimeve.

### **II.1.2.2 Drejtoria Juridike dhe Proçedurave**

Drejtoria Juridike dhe Proçedurave realizon argumentimin juridik të produkteve të veprimtarisë së Sekretariatit, drafton aktet rregullatore në zbatim të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe përfaqëson Autoritetin në proceset gjyqësore në mbrojtje të vendimeve të Komisionit ndaj akt-pasive nga palët e prekura. Kjo drejtori është e organizuar në dy sektorë: Sektori i Përafrimit të Legjislacionit dhe Proçedurave, i cili ka si detyrë kryesore përafrimin e legjislacionit sekondar me atë të Bashkimit Europian si dhe ndjekjen e detyrimeve të Autoritetit të Konkurrencës që rrjedhin nga MSA, të përcaktuara në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA); si dhe Sektori i Çështjeve Juridike dhe Hetimit, i cili ka si detyrë kryesore përgatitjen dhe përfaqësimin në seancat e çështjeve gjyqësore në mbrojtje të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës.

### **II.1.2.3 Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme**

Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme është struktura mbështetëse e funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës në realizimin e misionit të tij për ruajtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Kjo drejtori realizon manaxhimin e burimeve njerëzore në përputhje me kërkesat dhe procedurat e ligjit nr 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, programon zhvillimin e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve duke shfrytëzuar të gjitha burimet e mundshme si OECD, ICN, RCC, ITAP, Universiteti i Tiranës etj.

Gjatë vitit 2009 janë organizuar 3 procedura konkurimi në pozicionin “inspektor” në zbatim të kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës sipas ligjit nr. 8549 “Për statusin e nëpunësit civil”, dy prej të cilave të shkaktuara nga largimi sipas kërkesës në institucione të tjera.

Një drejtim tjetër i punës së kësaj drejtorie është mbulimi i veprimtarisë financiare të Autoritetit dhe mbajtja e përgjegjësisë së plotë për të gjitha procedurat e hartimit dhe të administrimit të fondeve të buxhetit, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e buxhetit të Shtetit Shqiptar.

#### **II.1.2.4 Sektori i studimit dhe analizës**

Në bazë të vendimit Nr.96 datë 30.04.2007 për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës, ky sektor ka si mision vëzhgimin e kushteve dhe kryerjen e analizave ekonomike të strukturave të ndryshme të tregut. Detyra e tij kryesore është identifikimi fillestar i sjelljeve antikonkurruese në treg, në zbatim të ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Nëpërmjet mbledhjes periodike të informacionit, vlerësimit të të dhënave si dhe analizave të kryera nga ky sektor në formën e studimeve mbi tregun, synohet të krijohet një pamje e përgjithshme e tregut nga monitorimi, dhe informacioni i nxjerrë prej sektorit shërben si ndihmesë për sektorët e tjerë të Autoritetit të Konkurrencës në hetimin e mëtejshëm të elementëve anti-konkurrues.

Pavarësisht nga vendosja e punonjësve në sektorë apo drejtori specifike, veçoria e punës në Autoritetin e Konkurrencës është puna në grup. Pra, në çdo rast hetimi, grupet e punës përmbajnë punonjës që i përkasin sektorëve apo drejtorive të ndryshme.

## **II.2 Forcimi i kapaciteteve administrative**

Gjatë vitit 2009 nëpunësit e Autoritetit të Konkurrencës janë trajnuar në programe të ndryshme brenda dhe jashtë vendit në fushën e konkurrencës sipas nevojave për forcimin e kapaciteteve administrative në funksion të zbatimit të ligjit. Kështu nga programet e trajnimit të ofruara nga OECD, TAIEX(BE), International Competition Network (ICN) kanë përfituar rreth 25 persona, 100 për qind e nëpunësve të ngarkuar me detyrat funksionale të zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Trajnimet janë organizuar sipas nevojave të sektorëve të veçantë të Sekretariatit dhe një vëmendje më e madhe i është kushtuar nëpunësve të rinj. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të Autoritetit të Konkurrencës ka qenë interaktive me prezantime rastesh të vendimmarrjes së Komisionit të Konkurrencës si dhe me diskutime rreth çështjeve kryesore që përballen sot Autoritetet e Konkurrencës në vendet në zhvillim.

Komisioni European nëpërmjet agjencisë së trajnimeve TAIEX (Instrumenti i Shkëmbimit të Informacionit dhe Asistencës Teknike) zhvilloi në muajin Mars 2009 një trajnim në Tiranë për stafin e Autoritetit të Konkurrencës dhe palëve të interesit për zbatimin e ligjit të konkurrencës në vendet me ekonomi të vogël si Shqipëria. Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës paraqiti sfidat e Autoritetit të Konkurrencës në zbatimin e ligjit dhe Politikës Kombëtare të Konkurrencës për vende me ekonomi të vogël dhe relativisht informale si rasti i Shqipërisë.

Gjatë vitit 2009 qendra rajonale e OECD-së për konkurrencën në Hungari për organizimin për herë të parë të një workshopi jashtë Budapestit zgjodhi Shqipërinë. Ky workshop u zhvillua në muajin qershor në Durrës me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të më shumë se 15 vendeve dhe u fokusua tërësisht në rastet e hetuara nga ana e Autoritetit të Konkurrencës gjatë 5 viteve të aktivitetit të tij.

Gjithashtu të gjithë nëpunësit civil kanë ndjekur kurset e organizuara nga Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, si kurset e detyrueshme, ashtu edhe të temave të ndryshme sipas kërkesave të drejtorive të Autoritetit të Konkurrencës.

### **III. Aktiviteti i Autoritetit në zbatim të tre shtyllave kryesore të ligjit të konkurrencës**

#### ***III.1 Marrëveshjet e ndaluara***

Marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që: caktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi; kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet; ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit; janë gjithmonë të ndaluara. Fiksimi i çmimeve dhe kufizimi i prodhimit bëjnë që klientët të paguajnë çmime më të larta ose mos marrjen e sasive të dëshiruara. Marrëveshjet e ndaluara dëmtojnë mirëqenien sociale, krijojnë ineficencë dhe kalojnë mirëqenien nga konsumatorët tek pjesëmarrësit në marrëveshje.

Autoriteti i Konkurrencës ka bërë monitorime, analiza dhe hetime, me synimin e zbulimit të marrëveshjeve apo të praktikave të koordinuara midis operatorëve në disa tregje, të cilat janë në vijim:

#### **III.1.1. Hetimi i thelluar në tregun e sigurimeve për produktin e sigurimit të detyrueshëm, TPL e brendshme**

Sikurse është raportuar edhe në vitin e kaluar, pas përfundimit të procesit gjyqësor në apel, Autoriteti i Konkurrencës vazhdoi procedurat e hetimit të thelluar në tregun e sigurimeve për produktin e sigurimit të detyrueshëm, TPL e brendshme. Në përfundim të hetimit, Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr 105 date 24.03.2009 vendosi me shumicë votash t'i rekomandojë Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare të njoftojë Autoritetin e Konkurrencës për çdo projekt akt normativ që mund të ketë pasoja mbi konkurrencën në treg dhe të kërkojë opinionin e Autoritetit për çdo ndryshim në lidhje me strukturën e tregut të sigurimeve, që mund të sjellë pasoja për konkurrencën.

#### **III.1.2 Hetimi i Thelluar ne Tregun e Karburanteve**

Sikurse është paraqitur në raportin vjetor për vitin 2008, Autoriteti i Konkurrencës kishte hapur procedurën e hetimit të thelluar në tregun e importit të dhe të shitjes me shumicë të karburanteve ndaj ndërmarrjeve me fuqi të ndjeshme në treg, i cili synonte të evidentonte sjelljen e operatorëve në treg për mundësinë e ekzistencës së praktikave anti-konkurrese në këtë treg., Pasi zbatoi procedurat e hetimit të thelluar, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, paraqiti raportin e hetimit të thelluar, dhe në zbatim të Nenit 39 të ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës", Komisioni i Konkurrencës organizoi seancat dëgjimore duke iu dhënë të drejtën palëve të konsultohen me dosjet përkatëse si dhe të paraqesin pretendimet e tyre me shkrim dhe në mënyrë verbale.

Gjatë realizimit të hetimit në tregun e karburanteve, për një analizë më objektive të të gjithë faktorëve që veprojnë në funksionimin e tregut, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë në konsideratë jo vetëm sjelljen e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e shitjes me shumicë të karburanteve, por edhe efektin e akteve normative dhe të praktikave të ndjekura nga organet tatimore dhe doganore shqetësim ky i ngritur edhe gjatë seancave dëgjimore me ndërmarrjet e importit dhe të tregtimit me shumicë të hidrokarbureve. Në përfundim të procedurave, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me shumicë votash për vendimin nr 117 dhe 118 datë 29.05.2009.

Komisioni i Konkurrencës në Vendimin nr 117 date 29.05.2009 u shpreh se gjatë periudhës objekt hetimi, në tregun e importit dhe të shitjes me shumicë të karburanteve, evidencat nuk provojnë mjaftueshëm ekzistencën apo jo të sjelljeve të koordinuara në aplikimin e çmimeve të shitjes me shumicë midis ndërmarrjeve objekt hetimi. Në këto kushte u vendos që Sekretariati të zgjerojë monitorimin në tregun e prodhimit vendas të karburanteve dhe shpërndarjes në nivelin e shitjes me shumicë dhe pakicë.

Vendimin nr 118 date 29.05.2009 “Për disa rekomandime për aktet ligjore dhe nënligjore që ndikojnë në nivelin e konkurrencës në tregun e importit dhe të shitjes me shumicë të karburanteve” ka marrë në shqyrtim një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore që kanë impakt në konkurrencën e lirë dhe efektive në treg, duke dhënë rekomandimet përkatëse si: Kuvendit të Shqipërisë ndryshimin e nenit 40 të Kodit Doganor si dhe disa ndryshime në Ligjin e Hidrokarbureve nr 8450 date 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”; dhe Ministrisë së Financave ndryshimin e pikës 9.4 të Udhëzimit nr 17 date 13.05.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” duke vendosur një afat kohor, i cili do të mundësojë realizimin e transparencës së çmimeve.

### **III.1.3 Hetimi i thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit**

Sikurse është raportuar edhe më parë në muajin tetor të vitit 2008, ishte hapur procedura e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve që operonin në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit për prodhimin e bukës për periudhën Janar 2005- 31 Gusht 2008. Procedurat e hetimit të thelluar të ndjekura nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës vazhduan gjatë vitit 2009. Gjatë inspektimeve u siguruan evidenca që vërtetojnë ekzistencën e një marrëveshjeje të ndaluar horizontale midis dy operatorve të cilët për shkak të integritimit vertikal ka sjellë pasojë në tregun e shitjes së miellit, pasojë e shprehur nëpërmjet fiksimit të çmimit për një periudhë kohore. Kjo formë e marrëveshjes konsiderohet marrëveshje e ndaluar pasi bie në kundërshtim me nenin 4 pika 1, germa “a” dhe “c” të Ligjit nr 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe sjell si pasojë pengimin, kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg.

Në vazhdim të procedurave, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr.113, datë 19.05.2009, vendosi ndalimin e marrëveshjes midis ndërmarrjeve “Bloja” sha dhe “Atlas” Sha, si marrëveshje e ndaluar, e cila bie në kundërshtim me nenin 4 të ligjit. Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të Sekretariatit dhe pas shqyrtimit të pretendimeve të ndërmarrjeve Atlas sha dhe Bloja sha në seancën dëgjimore të organizuar nga Komisioni i Konkurrencës me 27.07.2009 dhe ato me shkrim të dërguara pranë Autoritetit të Konkurrencës, u shpreh me Vendimin Nr 125 datë 08.10.2009 dhe vendosi të gjobisë ndërmarrjen Bloja sha me gjobë në shumën 38 548 251 dhe ndërmarrjen Atlas sha në shumën 27 848 563 për shkeljen e Ligjit Nr 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr 126, datë 08.10.2009, në vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg dhe të faktorëve që ndikojnë në këtë sjellje, është drejtuar dhe nga interesi publik në tërësi dhe ai i konsumatoreve në veçanti dhe i rekomandoi: Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të rishikojë praktikën e referencës në tregun e importit të grurit për efektet e mundshme që mund të sjellin kufizim të konkurrencës në treg; Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve që gjatë praktikave të rivlerësimeve të mbajë parasysh efektet që mund të sjellin në treg për konkurrencën; Insitutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar që të sigurojë se pasqyrat financiare pasqyrojnë saktë dhe drejt gjendjen pasurore dhe situatën financiare të ndërmarrjeve Atlas Sha dhe Bloja Sha, si dy ndërmarrje me fuqi të madhe në treg.

### **III.1.4 Hetimi i thelluar në tregun e prokurimeve publike**

Për rëndësinë që ka efica e prokurimit të shërbimeve dhe mallrave të cilat zënë rreth 15% të GDP, si të ardhura që vijnë nga taksapaguesit si dhe për rritjen e konkurrencës nga ana e ofertuesve, Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut, në zbatim të nenit 28, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, monitoroi dhe analizoi kushtet e tregut lidhur me kufizimin e konkurrencës në tregun e prokurimit të automjeteve të reja dhe i propozoi hapjen e hetimit paraprak në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja. për të vërtetuar nëse ka apo jo ndërmarrje, që kryejnë veprime apo sjellje me elementë antikonkurrues, të cilat bien ndesh me Ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Metodologjia e realizimit të këtij hetimi po bazohet në praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe të përgjithësuar nga OECD. Marrëveshjet në oferta ose marrëveshje të ndaluara në tendera janë praktika të ndaluara në të gjitha vendet pjesëmarrëse të OECD, dhe mund të hetohen dhe sanksionohen sipas ligjit dhe rregullave të konkurrencës. Nga hetimi paraprak në tregun e prokurimeve të makinave të reja rezulton se potencialisht ekzistojnë evidencat e bashkëpunimit midis disa ndërmarrjeve për pjesëmarrje në prokurimet publike, çka mund të përbëjë një praktikë të bashkërenduar ndërmjet ndërmarrjeve që veprojnë në tregun përkatës.

Në vijim të procedurave, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr 135 datë 21.12.2009 vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e

prokurimeve te automjeteve te reja, me objekt ekzistencën ose jo të marrëveshjeve në oferta që kufizojnë konkurrencën në tregun e prokurimit. Gjithashtu, u realizua vleresimi paraprak i një kontrate midis dy operatorëve për kufizimet e mundshme të konkurrencës nëpërmjet neneve të saj. Aktualisht autoriteti është në vazhdim të procedurave.

### **III.1.5 Përjashtimi nga ndalimi i marrëveshjes**

Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të Ligjit Nr 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, jep autorizimin për përjashtim nga ndalimi të marrëveshjeve për shkak të efikasitetit ekonomike. Marrëveshja duhet të kontribuojë në përmirësimin e prodhimit, shpërndarjes së prodhimit apo promovimit të progresit teknik ose ekonomik, si dhe të garantojë që konsumatorët duhet të marrin një pjesë të barabartë të përfitimeve të nxjerra. Pra, kufizimi duhet të jetë i domosdoshëm për arritjen e këtyre objektivave. Por, marrëveshja nuk duhet t’u japë palëve mundësinë të eliminojnë konkurrencën, në lidhje me pjesën thelbësore të produktit në fjalë.

Gjatë vitit 2009 pranë Autoriteti i Konkurrencës është depozituar kërkesa për përjashtimin nga ndalimi i marrëveshjes së lidhur ndërmjet “Tirana International Airport” shpk dhe “AIR BP Albania” Sh.a “Për sigurimin e depozitimit dhe tregtimit të karburantit për avionë, si dhe të shërbimit të furnizimit të avionëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza”. Raporti i paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës konkludoi se zbatimi i kësaj marrëveshje ka efekte në përmirësimin e shpërndarjes së produktit dhe shërbimit, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit, uljen e kostos së shërbimit dhe produktit, realizon një pjesëmarrje më të drejtë në përfitim nga ana e konsumatoreve, nxit kërkimin dhe zhvillimin dhe përhapjen e njohurive profesionale, rrit sigurinë për sasinë e mallrave që ofron dhe realizon mbulimin e plote financiar te çdo përgjegjësie te mundshme.

Njoftimi për përjashtim nga ndalimi i marrëveshjes u bë publike për të tërhequr opinionin e mundshëm të palëve të treta të prekura. Bazuar ne Raportin e paraqitur nga Sekretariati dhe në kushtet e mos depozitimit të ndonjë opinioni, Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr 116 datë 29.05.2009 e përjashtoi marrëveshjen nga ndalimi i parashikuar në nenin 4 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **III.2. Abuzimi me pozitën dominuese**

Sjellja e ndërmarrjeve me pozitë dominuese në tregjet përkatëse ka qenë një nga shtyllat kryesore të punës së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2009. Ndërmarrjet me pozitë dominuese mund të abuzojnë si në rastet e nxjerrjes së konkurrentëve nga tregu ashtu dhe vendosjes së çmimeve apo praktikave tregtare që çenojnë konkurrencën në treg dhe dëmtojnë klientët e tyre. Komisioni ka dhënë propozime për masa konkrete që rregullojnë sjelljen e ndërmarrjeve me pozitë dominuese, si sa i



përket konkurrencës me konkurrentët më të vegjël ashtu dhe në rastet e kontrollit të përqëndrimeve ku përfshihen konkurrentë me pjesë të konsiderueshme tregu.

### **III.2.1 Hetimi i thelluar në tregun e bonove të thesarit**

Gjatë vitit 2009 Sekretariati i Autoriteti i Konkurrencës përfundoi hetimin e thelluar për abuzimin ose jo me pozitën dominuese të Bankës Raiffeisen në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit, i cili kishte filluar në dhjetor të vitit 2008. Bazuar në raportin e hetimit të thelluar i përgatitur nga Sekretariatit, Komisioni i Konkurrencës organizoi në muajin dhjetor tryezën konsultative me përfaqësues të Ministrisë së Financave, Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Mbykëqyrjes Financiare për të tërhequr opinionet e tyre mbi draft rekomandimet e propozuara për ndryshimet potenciale në aktet normative që funksionojnë në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit. Gjithashtu, gjatë muajit janar të 2010 është realizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit ligjor dhe përfaqësinë e bankës objekt hetimi. Aktualisht, pala ka paraqitur informacionin shtesë dhe pretendimet me shkrim, të cilat do të jenë objekt i vazhdimit të procedurave të vendimmarrjeve nga Komisioni.

### **III.2.2 Hetimi në tregun e lëndës djegëse për automjete Diesel (D2)**

Gjatë vitit 2009 Autoriteti i Konkurrencës, pas realizimit të përqëndrimit të realizuar nga shitblerja e 85% të aksioneve të ARMO sh.a nga shoqëria ANIKA MERCURIA REFINERY ASSOCIATED OIL sh.a, vendosi të monitorojë sjelljen e ndërmarrjes ARMO në tregun e karburanteve veçanërisht për produktin Diesel (D2). Gjatë këtij monitorimi Autoriteti i Konkurrencës i ka kërkuar shoqërisë ARMO informacion në lidhje me prodhimin dhe tregtimin e karburanteve. Pavarësisht kërkesave të përsëritura të Autoritetit për vënien në dispozicion të informacionit, ndërmarrja ARMO ka dërguar informacione përgjithësisht të paplota dhe jashtë afateve të përcaktuara. Prandaj Sekretari i Përgjithshëm, me anë të vendimit Nr.262 datë 27.07.2009, vendosi hapjes e hetimit paraprak mbi sjelljen e ndërmarrjes 'ARMO' sh.a në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë e pakicë të produktit të lëndës djegëse për automjete Gazoil (D2).

Bazuar në gjetjet e hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr.129, datë 19.11.2009 vendosi hapjen e hetimit të thelluar në tregun e produktit lëndë djegëse Diesel (D2), e cila ka si objekt vërtetimin e abuzimit me pozitën dominuese të shoqërisë "ARMO" procedurë e cila pritet të përfundojë brenda treumjorit të parë të vitit 2010.

### **III.3 Kontrolli i Përqëndrimeve**

Në politikën e konkurrencës, përgjithësisht, përqëndrimet e ndërmarrjeve konsiderohen si procese që sjellin rritjen e eficiencës dhe reduktimin e kostove. Megjithatë, gjatë vlerësimit nuk duhen anashkaluar pasojat negative që ato shkaktojnë, pasi mund të shkaktojnë krijimin ose forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes së përqëndruar. Në këtë këndvështrim analiza e ndryshimeve të strukturës së tregut dhe pasojat që mund të ketë në tregjet përkatëse është një nga

detyrat e Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”

Gjatë vitit 2009 Komisioni i Konkurrencës ka autorizuar 8 përqëndrime si dhe ka dhënë sqarimet për lejimin e disa transaksioneve që nuk ndryshonin kontrollin e ndërmarrjeve objekt përqëndrimi apo nuk plotësoheshin kushtet ligjore (minimumet e xhirove të parashikuara në ligj) që përqëndrimet të jenë objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **III.3.1 Tregu financiar**

Vendimi Nr. 106 Datë 23 .04. 2009 autorizon transaksionin për përfitim kontrolli të drejtpërdrejtë në ndërmarrjen Sigma ShA nga ndërmarrja Vienna Insurance Group, nëpërmjet blerjes së 87% të kapitalit, pasi nuk sillte asnjë ndryshim në strukturën e përgjithshme të tregut shqiptar të sigurimeve dhe tregut të pensioneve private. Për më tepër, pritet që ndikimi i investitorit të huaj dhe me eksperiencë në tregun përkatës ndërkombëtar të sjellë ndikime pozitive në zhvillimet e tregut të sigurimeve.

Vendimin Nr.119, datë 26.06.2009, të Komisionit të Konkurrencës, për autorizimin e përqëndrimit për përfitim e plotë të kontrollit në shoqërinë Banka e Kreditit të Shqipërisë, nga ndërmarrja Anika Enterprises SA.

Vendimin Nr.128, datë 05. 11. 2009, të Komisionit të Konkurrencës, për autorizimin e përqëndrimit që konsiston në përfitim e kontrollit të vetëm në Bankën Kombëtare Tregtare SHA, nëpërmjet blerjes së aksioneve të zotëruara nga BERZH dhe IFC, në favor të aksionerit mazhoritar Calik Finansial Hizmetler A.S.,

### **III.3.2 Tregu i aviacionit civil**

Për herë të parë gjatë vitit 2009 Komisioni i Konkurrencës ka nisur një procedurë të kontrollit të përqëndrimit me nismën e vet parashikuar në nenin 49 të ligjit. Transaksioni i përqëndrimi midis Advanced Construction Group Shpk dhe Albania Airlines Mak Shpk ishte realizuar dhe nuk ishte njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës duke shkelur dispozitat e ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. Komisioni me Vendimin Nr.122, datë 17. 09. 2009 ka autorizuar kontrollin e përqëndrimit të realizuar “Mbi Përfitim e plotë të kontrollit nga shoqëria Advanced Construction Group Shpk në shoqërinë Albania Airlines Mak Sh.p.k. Gjatë procedurës së vlerësimit të transaksionit shoqëria Advanced Construction Group Shpks nuk iu përgjigj kërkesave të përsëritura edhe me vendim të komisionit të konkurrencës për dhënie të informacionit , në këtë mënyrë në zbatim të nenit 73 të Ligjit, u ndërmorrën saksione për mos dhënie informacioni sipas Vendimit Nr.123, datë 18. 09. 2009.

Me Vendimin Nr. 108 Datë 23.04.2009, Komisioni ka autorizuar përqëndrimin e realizuar për përfitim të kontrollit në shoqërinë Austrian Airlines AG, nga shoqëria

Deutsche Lufthansa AG nëpërmjet blerjes së 75% të aksioneve, si një përqëndrim nuk sillte efekte në strukturën e tregut shqipëtar.

### **III.3.3 Në sektorin e energjisë**

Me Vendimin Nr. 111 Datë 15.05.2009, Komisioni ka autorizuar përqëndrimin e realizuar për përfitim e kontrollit nga shoqëria CEZ a.s në shoqërinë OSSH SH.A, nëpërmjet blerjes 76% të aksioneve me pronësi shtetërore. OSSH është operatori i vetëm publik që vepron në tregun e brendshëm të shpërndarjes së energjisë elektrike me objekt: (i) Furnizimin dhe shitjen e energjisë elektrike tek klientët tariforë, me përjashtim të klientëve të kualifikuar, (ii) Operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të shpërndarjes të energjisë elektrike, të mjediseve dhe paisjeve në administrim të saj, (iii) Menaxhimi i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike; (iv) Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike. Përfitimi i kontrollit për 76% të kapitalit aksioner në shoqërinë OSSH, pritet të ketë ndikime pozitive në treg pasi ky përqëndrim në periudhat afat gjatë do të ndikojë në rritjen e konsumit të energjisë elektrike në masën 5% në vit, reduktimin e humbjeve, rritjen e akëtive, duke përmirësuar kështu sigurimin e furnizimit me energji elektrike. Theksojmë se përfitimi i kontrollit influencues nga shoqëria CEZ në shoqërinë OSSH SHA, pavarësisht se nuk ndryshoi strukturën në tregun e shpërndarjes së energjisë elektrike, mbetet nën monitorimin e vazhdueshëm të Autoritetit të Konkurrencës, për sa i takon sjelljes së tij në treg.

Me Vendimin Nr. 127, datë 15. 10. 2009, Komisioni ka autorizuar përqëndrimin e realizuar për përfitim kontrolli në shoqërinë BP Greece Limited, nga shoqëria Hellenic Petroleum SA nëpërmjet blerjes 100% të veprimtarisë ekonomike të tregtimit të shoqërisë BP Hellas SA . Në Shqipëri, Hellenic Petroleum është e pranishme në nivelin e shumicës nëpërmjet shoqërisë Global Petroleum Albania ShA, me pjesë tregu në total 10% dhe në tregun me pakicës nëpërmjet shoqërisë bijë të saj Elda Petroleum Albania Shpk, me pjesë tregu 5%.

### **Raste të ndryshme që janë konsideruar ose jo përqëndrime**

*Rasti i Sigal SHA:* Ky transaksion që sjell një reduktim të numrit të aksionerëve si dhe ndryshim në kapitalin aksionar dhe të së drejtës së votës brenda shoqërisë Sigal SHA, pa ndryshuar formën e kontrollit, nuk është konsideruar përqëndrim në kuptim të nenit 10 të Ligjit. Për këtë palët janë njoftuar me anë të letre qetësuese, se ky rast nuk konsiderohet përqëndrim dhe si rrjedhojë nuk ka nevojë për t'u autorizuar.

*Rasti Cosmofon/ Telekom Slovenie:* mbyllur me letër qetësuese, mbasi nuk është konsideruar përqëndrim (objekt i transaksionit është përfitimi i kontrollit të një shoqërie jashtë tregut relevant të produktit dhe atij gjeografik të shoqërisë AOL, ku Telekom Slovenie është aksioneri kontrollues.

*Rasti Bindi Integrated Services ShA (BIS)/ AlbaniaOnline Shpk (AOL):* Leter sqaruese: Transaksioni nuk i është nënshtruar procedurës së kontrollit të

përqendrimeve, mbasi xhiro e realizuar në tregun e brendshëm nga shoqëritë pjesëmarrëse në transaksion nuk e kalon pragun e parashikuar ligjor dhe për rrjedhojë përqendrimi nuk është objekt autorizimi nga Autoriteti i Konkurrencës

*Rasti CEZ as/ Lumius spol srl; dhe Rasti CEZ AS/ Jadrova a vyradovacia spolocnost”, a.s:* Janë dy transaksione që në kuptim të nenit 10 pika 1 shkronja a) dhe c) e Ligjit Nr. 9121, date 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, konsiderohen përqendrime, por duke qënë se palët pjesëmarrëse veprojnë jashtë tregut përkatës të produktit dhe atij gjeografik të shoqërisë OSSH sh.a, transaksionet nuk janë objekt autorizimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

**Transaksione të ndryshme të realizuara brenda grupit:**

Mak-Albania Shpk/Mohammed Abdulmohsin Al Kharafi & Sons W.LL. Transaksioni ndodh brenda grupit Al Karafi dhe duke u konsideruar si një ristrukturim i brendshëm i grupit, por pa shkaktuar ndryshime në cilësinë e kontrollit nuk konsiderohet përqendrim në kuptim të nenit 10 të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Transaksioni i realizuar brenda aksionerëve të shoqërisë për ndryshimin e pronësisë në kapitalin aksionar në shoqërinë Calik-Seker Konsorsiyum Yatirim AS, nuk është konsideruar përqendrim, mbasi transaksioni ndodh brenda Konsorciumit, ku shoqëria Calik Holding fiton kontrollin duke rritur pjesëmarrjen në masën 76% të kapitalit aksionar, pra kemi të bëjmë me ndryshim aksionerësh, pa asnjë pasojë në kuotat e shoqërisë Calik Holding në Bankën Kombëtare Tregtare.

Komisioni i konkurrencës është shprehur me anë të një letre sqaruese lidhur me transaksionin mbi transferimin e aksioneve që ndodhi brenda grupit Intesa SanPaolo, duke mos e konsideruar këtë rast si përqendrim në kuptim të nenit 10 të Ligjit.

Transaksionin me objekt: Zgjerimin e kontrollit të shoqërisë Cosmote në shoqërinë AMC SHA, nëpërmjet blerjes së pjesës prej 12.5% të kapitalit aksionar në zotërim të shtetit shqiptar, nuk është konsideruar përqendrim mbasi aktualisht shoqëria Cosmote ka kontrollin influencues në shoqërinë AMC sh.a.

### **III.4 Monitorimet**

#### **III.4.1 Monitorimi i shërbimeve të Profesioneve të Lira**

Në zbatim nenit 28, germa a të ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Sekretariati monitoroi dhe analizoi kushtet e tregut lidhur me kufizimin e konkurrencës në tregjet përkatëse të profesioneve të lira si: shërbimi i noterisë, avokatisë, farmacistëve, stomatologëve, eksperteve kontabël të autorizuar dhe kontabilistëve të miratuar.

Monitorimi u realizua sepse në këto shërbime ka asimetri informacioni, në mes të konsumatorëve dhe ofruesve të shërbimeve profesionale, konsumatorët mund të mos kenë njohuri dhe për këtë arsye e gjejnë të vështirë për të gjykuar cilësinë e shërbimeve dhe ato të blerjes, ofrimi i një shërbimi mund të ketë një ndikim mbi palët e treta si dhe tek blerësi i shërbimit, si dhe shërbimet profesionale mendohet për të prodhuar të mira publike të cilat janë me vlerë për shoqërinë në përgjithësi.

Monitorimi konsistoi në shqyrtimin e kufizimeve për eliminimin e tyre në fushën e shërbimeve profesionale si pasoje e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për shkak se këto tregje karakterizohen në përgjithësi nga nivele të larta rregullimi nga aktet ligjore dhe nënligjore. Janë pesë kategori të kufizimeve që konsiderohen të rëndësishme nga Komisioni Europian për profesionet e lira: çmimet e fiksuara, çmimet e rekomanduara, rregullat e reklamës, kërkesat e hyrjes dhe të drejtat e rezervuara, praktikat dhe rregullat që udhëheqin biznesin, të cilat mund të eliminojnë/kufizojnë konkurrencën midis ofruesve të shërbimit.

Nga informacioni i grumbulluar, baza ligjore e funksionimit si dhe nga studimi i rasteve të ngjashme për profesionet e lira, vihet re se mënyra e funksionimit dhe baza ligjore janë përafuar me ato të vendeve të BE-së.

#### **III.4.2. Monitorimi dhe shqyrtimi i ankesës së farmacistëve të rrjetit të hapur ndaj ISKSH**

Autoriteti i Konkurrencës monitoroi kufizimet e mundshme të konkurrencës bazuar në ankesën e sindikatës së pavarur të farmacistëve të Rrjetit të Hapur lidhur me Vendimin e Këshillit Administrativ të ISKSH Nr 50, datë 12.12.2008 “Për miratimin e kontratave tip midis ISKSH, farmacive dhe agjencive farmaceutike, depove importuese, distributorëve të barnave si dhe kontratën trepalëshe ndërmjet ISKSH-së – QSUT-së – Depove të Barnave për vitin 2009” Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të ankesës datë 23.01.2009 të Sindikatës së Pavarur të Farmacistëve të Rrjetit të Hapur; relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm; pretendimeve të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor në seancën konsultative me Komisionin e Konkurrencës me datë 23 prill 2009; me vendimin Nr 109, datë 04.05.2009 vendosi: t’i rekomandojë Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, rishikimin e pikës 1 të Vendimit të tij Nr. 50, datë 12.12.2008 “Për miratimin e kontratave tip midis ISKSH, farmacive dhe agjencive farmaceutike,

depove importuese, distributore të barnave si dhe kontratën trepalëshe ndërmjet ISKSH-së – QSUT-së – Depove të Barnave për vitin 2009”.

Sektori i studimit dhe i analizës së tregut ka vazhduar monitorimin e këtij tregu dhe është në procesin e draftimit të raportit të monitorimit të tregut farmaceutik

### **III.4.3. Monitorimi dhe shqyrtimi i ankesës së shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike**

Autoriteti i Konkurrencës shqyrtoi ankesat e shoqërive të ruajtjes dhe sigurisë fizike. Në ankesat e tyre SHRSF-të pretendojnë së në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe kërkesave për kualifikim, është shkelur legjislacioni mbi prokurimin publik.

Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr 114 date 26.05.2009 i rekomandoi: autoritetit kontraktor "Drejtorisë së Përgjithshme të Prokurimeve të Përqendruara" pranë Ministrisë së Brendshme, të rrisë numrin e loteve të kontratës publike me objekt "Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me subjekte private të objekteve të Kryeministrisë, Ministrive dhe institucioneve në varësi të tyre" me qëllim mundësimin e paraqitjes së kërkesave të grupuara sipas madhësive të krahasueshme të autoriteteve kontraktore me madhësinë e ofertave individuale nga operatorët ekonomikë. Në këtë mënyrë mundësohet rritja e konkurrencës midis operatorëve që plotësojnë nivelet respektive të kërkesës; Agjencisë së Prokurimit Publik që në varësi të natyrës së kontratës që prokurohet, t'ju propozojë autoriteteve kontraktore ndarjen e kontratave në lote/nën-lote (pra në kategori) në mënyrë të tillë që të mundësohet një pjesëmarrje sa më e gjerë e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimeve publike duke siguruar një përdorim sa më të mirë të fondeve publike, nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë sipas madhësisë së ndërmarrjeve të vogla e të mesme në këto procedura, si dhe nxitjen e konkurrencës midis tyre.

### **III.4.4 Monitorim i tregut të telefonisë**

Gjatë vitit 2009 Autoriteti i Konkurrencës ka shqyrtuar ankesën e shoqërisë Abissnet kundrejt shoqërisë AMC sh.a. Kjo ankesë kishte të bënte me ndërprerjen e shërbimit të interkoneksionit nga ana e shoqërisë AMC ndaj shoqërisë Abissnet sh.a dhe moslidhjen e marrëveshjes së re të interkoneksionit të drejtpërdrejtë. Autoriteti i Konkurrencës pasi shqyrtoi ankesën e shoqërisë Abissnet arriti në konkluzionin se: lidhur me kërkesën e ndërmarrjes Abissnet sh.a për hapjen e hetimit paraprak për abuzimin me pozitën dominuese të ndërmarrjes AMC sh.a për moslidhje të marrëveshjes së re të interkoneksionit të drejtpërdrejtë, në fazën ku palët nuk kanë arritur ende në përfundimin e marrëveshjes midis tyre nuk është Autoriteti i Konkurrencës organi kompetent për zgjidhjen e kësaj shtate sepse ndërmarrja Abissnet sh.a duhet të ezaurojë të gjithë procedurën ligjore administrative të përcaktuar në Ligjin "Për komunikimet elektronike".

### **III.4.5 E drejta e autorit**

Gjatë muajit shtator të vitit 2009 Autoriteti i Konkurrencës ka monitoruar tregun e të drejtës së autorit. Në këtë monitorim u vu re se tregu i të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të është në fazat e tij fillestare. Problemi kryesor që ekziston në këtë treg është niveli i lartë i piraterisë, që sjell deformim dhe mos funksionim të tregut sipas rregullave. Tregtimi i produkteve të autorëve nëpërmjet internetit dhe site-ve pirate bën që monitorimi i këtij tregu të jetë shumë i vështirë për infrastrukturën që posedojnë agjensitë si dhe Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit.

Për shkak të arsyeve të përmendura më sipër u vendos të organizohet një workshop me Zyrën Shqiptare për të Drejtën e Autorit duke synuar rritjen e kulturës së konkurrencës në këtë treg. Gjithashtu Autoriteti i Konkurrencës mund të ndërhyjë ex-ante në tregun e pronësisë intelektuale duke ndihmuar Shoqatat e të Drejtës së Autorit në përcaktimin e elementëve problematikë në kuptim të kufizimit të konkurrencës në treg.

### **III.4.6 Monitorimi i tregut bankar**

#### **- Tregu i depozitave dhe kredive për periudhën qershor- shtator 2009**

Ky monitorim ka patur për qëllim vlerësimin e sjelljes së bankave të nivelit të dytë në fushatën sezonale të rritjes së interesave të depozitave. Gjatë këtij monitorimi i është kërkuar informacion Bankës së Shqipërisë mbi volumin e depozitave dhe kredive për bankat e nivelit të dytë, sipas monedhës, afateve të maturimit për depozitat dhe llojit të kredive dhe grupit të klientëve për kreditë si dhe normat e interesit. Nga ky studim është konkluduar se në tregun e depozitave dhe kredive nuk ka ndërmarrje me pozite dominuese individuale dhe kolektive, të cilat të kenë mundësi të ushtrojnë “çmime grabitqare” në treg. Rritja e interesit të depozitave nuk ka qenë shkak i ndonjë strategjie antikonkurrese të ndonjë prej bankave të nivelit të dytë, por ka qenë një politikë e bankave me efekt sezonal për të grumbulluar likuiditetet e lira nga ardhja e emigrantëve. Kjo sjellje mjaft agresive e bankave në këtë periudhë ka qenë një parapërgatitje e tyre për mungesën e likuiditetit dhe krizën financiare globale që kishte prekur pjesën më të madhe të botës dhe mendohej të prekte edhe Shqipërinë.

#### **- Monitorimi i tregut të shërbimeve bankare me pakicë (retail)**

Gjate fundit të vitit 2009, u iniciua monitorimi i tregut të shërbimeve bankare, i cili ka për objekt vlerësimin e sjelljes së bankave të nivelit të dytë në lidhje me transparencën dhe nivelin e tarifave të shërbimeve bankare. Për realizimin e këtij monitorimi, grupi i punës u fokusua në dy drejtime (i) transparencën e bankave në lidhje me publikimin dhe informimin e klientëve dhe (ii) nivelin e tarifave të shërbimeve për Llogaritë Rrjedhëse, Çeqet, Kreditë dhe Overdraft, dhe Kartat Plastike.

Realizimi i monitorimit do të bazohet mbi metodologjitë për monitorime të tregut të shërbimeve bankare të realizuara nga Komisioni Europian dhe OECD dhe pritet të përfundojë në tremujorin e parë të vitit 2010.

## **IV. Advokatia e konkurrencës**

Advokatia është një nga aspektet e aktivitetit të Autoritetit të Konkurrencës i cili është i shprehur qartë në ligjin për mbrojtjen e konkurrencës dhe në politikën kombëtare të konkurrencës. Komisioni i konkurrencës, gjatë vitit 2009, është shprehur nëpërmjet 10 vendimeve në lidhje me rekomandimet nga rishikimi i akteve ligjore dhe nën ligjore që kanë qënë të draftuara apo në fuqi, të cilat kanë patur një ndikim të drejtëpërdrejtë apo jo të drejtëpërdrejtë në funksionimin e tregjeve në bazë të filozofizë së konkurrencës.

Ky funksion, gjatë vitit të kaluar, është realizuar nëpërmjet dy drejtimeve: vlerësimit të drafteve të akteve ligjore dhe nënligjore të institucioneve publike dhe të enteve rregullatore apo i analizave të tregjeve të realizuara nga entet rregullatore respektive dhe; vlerësimeve të akteve normative që janë analizuar gjatë monitorimeve apo hetimeve të realizuara nga Autoriteti i Konkurrencës për tregjet e përmendura në kreun e mësipërm.

### ***IV.1. Rekomandime mbi projektet e akteve normative***

Vlerësimi i projekt – Ligjit “Për auditimin ligjor të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, për të cilin është shprehur dhe Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 102 datë 17. 02. 2009. Krahas Ministrisë së Financave për tërheqjen e opinionit të institucionit të konkurrencës, Insituti Kombëtar i Auditëve paraqiti kërkesën për vlerësim nëse ka deformim të tregut të profesionit të auditit. Komisioni i Konkurrencës u shpreh se ligji në fjalë nuk përmban kufizim apo pengim të konkurrencës në lidhje me ushtrimin e profesioneve të lira. Ky vendim u konfirmua edhe nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese në lidhje me këtë ligj.

Vlerësimi i projekt-ligjit “Për ofertat publike të titujve”. Në vendimin Nr. 110 datë 15. 05. 2009 Komisioni i Konkurrencës ka rekomanduar që të vendoset referenca e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” mbi detyrimin për të njoftuar përqëndrimet që rrjedhin nga përfitimi i kontrollit

### ***IV.2. Rekomandime mbi aktet normative në tregjet e monitoruara, e hetuara, apo sipas ankesave***

Për mirë funksionimin e tregut të sigurimit të detyrueshëm TPL e brendshme, në përfundim të procedurave të hetimit (i trashëguar nga viti 2007 dhe i pezulluar me vendim gjykatë), Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 105 datë 24.03.2009 u shpreh me shumicë votash mbi domosdoshmërinë e konsultimit të akteve normative



dhe të të gjithë ndryshimeve strukturore të tregut nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Bazuar në ankesën e Sindikatës së Pavarur të farmacistëve të rrjetit të hapur, u realizua vlerësimi i Vendimit të Këshillit Administrativ të ISKSH-së Nr. 50, datë 12.12.2008. Komisionin i Konkurrencës është shprehur me shumicë votash me Vendimin Nr. 109 datë 04. 05. 2009 mbi rishikimin e pikës 1 të këtij vendimi, sipas të cilit ndahej fondi i rimbursimit në mënyrë të barabartë midis farmacive duke sjellë kushtëzime tek përzgjedhja e konsumatorit fundor

Bazuar në ankesat e shoqërive të ruajtjes dhe të sigurisë fizike u realizua vlerësimi ligjor për rritjen e konkurrencës në prokurimin publik të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike. Komisioni i Konkurrencës është shprehur me Vendimin Nr. 114 datë 26. 05. 2009, duke rekomanduar përjasjes së madhësisë së kërkesës me madhësinë e ofertës në mënyrë që të mundësohet rritja e konkurrencës midis operatorve që plotësojnë nivelet respektive të kërkesës si dhe rritjen e pjesëmarrjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Sikurse është paraqitur edhe në kreun e mësipërm, gjatë realizimit të analizës së faktorëve që kanë ndikuar në funksionimin e tregut të importit dhe të shitjes me shumicë të karburanteve, Komisioni i Konkurrencës është shprehur, me shumicë votash, me vendimin Nr. 118 datë 29. 05. 2009, mbi disa rekomandime të ndryshimeve të akteve ligjore që ndikojnë në rritjen e konkurrencës në këtë treg.

Gjithashtu, gjatë vlerësimit të faktoreve që kanë ndikuar në funksionimin e tregut të importit të grurit dhe të prodhimit e të shitjes së miellit për prodhim buke, Komisioni i Konkurrencës ka rekomanduar me vendimin Nr. 126 datë 8. 10. 2009, Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithëshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithëshme të Doganave që të marrin në konsideratë efektet e praktikave të rivlersimeve dhe të cmimeve të referencës në tregjet përkatëse për konkurrencën, si dhe i ka rekomanduar Insitutit të Ekspertve Kontabël të sigurojë që pasqyrat financiare të palëve objekt hetimi pasqyrojnë sakte dhe drejtë gjëndjen pasurore të tyre.

Vlerësimi i raportit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare “Analiza e Tregut Celular: Tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë i shërbimeve publike celulare”, ka mundësuar Komisionin e Konkurrencës të shprehet me Vendimin Nr. 124 datë 23. 09. 2009 për disa rekomandime në lidhje me aplikimin e metodologjisë së rregullimit të tarifave për shërbimin me kontratë dhe mesazhet elektronike (sms) si dhe liberalizimin e mëtejshëm të tregut nëpërmjet operatorit të katërt.

Vlerësimi i raportit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare “Analiza e tregut të telefonisë fikse: Tregjet me pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumicë të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjete fikse: Konsultim publik”, për të cilën Komisioni i Konkurrencës është shprehur me Vendimin Nr. 130 datë 23. 11. 2009 për disa rekomandime. Këto rekomandime

konsistojnë në aplikimin e metodologjive respektive derisa tarifat e shërbimeve të jenë të krahasueshme me ato të vëndeve të rajonit dhe të Bashkimit Europian si dhe orientimin e tarifave drejt kostove.

Bazuar në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga Enti Rregullator i Energjisë për të tërhequr opinionet e palëve të interesit mbi aplikimet e reja të KESH Sh.A, OST Sh.A dhe OSSH Sh.A., si dhe në aplikimet respektive, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 133 datë 14.12.2009 është shprehur mbi disa rekomandime adresuar ERE-së. Përgjithësisht, këto rekomandime konsistojnë në përcaktimin e tarifës të orientuar drejt kostos së gjenerimit dhe normës së kthimit të kapitalit; në Modelit të Tregut të Energjisë, dhe në Deklaratën Rregullatore.

Pavarësisht nga rekomandimet e dhëna, vihet re një neglizhencë e institucioneve publike dhe atyre rregullatore në zbatimin e detyrimit ligjor të shprehur në nënin 69 të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Për më tepër shumica e rekomandimeve të dhëna nuk janë marrë në konsideratë nga institucionet respektive, pavarësisht se gjatë marrjes së këtyre vendimeve Komisioni i Konkurrencës ka organizuar tryeza të rrumbullakta.

Autoriteti i Konkurrencës ka theksuar disa herë në mënyrë publike se mbrojtja e konkurrencës nuk mund të realizohet nga një institucion i vetëm, por kërkon një mentalitet të tregut funksional tek të gjitha ato institucione publike apo rregullatore që me veprimtarinë e tyre apo me aktet normative që amendojnë ndikojnë drejtëpërdrejtë apo indirekt në funksionimin e tregut bazuar në konkurrencën e lirë dhe efektive.

#### ***IV. 3 Hartimi dhe miratimi i kuadrit nënligjor***

Pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë, një hap i rëndësishëm është përqasja e plotë e legjislacionit në fushën e konkurrencës me atë të *Acquis* së EU. Zbatimi i angazhimeve të marra në kuadër të Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe përmbushja e detyrimeve që rrjedhin për përafrimin e legjislacionit, do të vazhdojë të mbetet prioritet në fushën e konkurrencës.

Rëndësi i është kushtuar edhe legjislacionit dytësor që është plotësuar me rregullore, udhëzime, etj, të cilat janë përafër duke marrë si referencë rregulloret, udhëzimet, vendimet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian të adoptuara në legjislacionin vendas, të cilat përcaktojnë në detaje dispozitat e Traktatit Themelues të BE-së në fushën e konkurrencës. Aktet nënligjore të hartuara dhe miratuara në zbatim të ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës" synojnë mundësimin e interpretimit dhe lehtësimin e procedurave gjatë proceseve hetimore dhe kontrollit të pëqëndrimeve. Kështu, gjatë vitit të kaluar, Autoriteti i Konkurrencës ka hartuar dhe janë vënë në funksionim rregulloret dhe udhëzimet e mëposhtme:

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr 120, datë 10.09.2009 ka miratuar Rregulloren “Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre”. Kjo rregullore synon përafrimin e dy akteve të Komunitetit Europian: Njoftimin e Komisionit Europian “Mbi imunitetin nga gjobat dhe zbritjen e gjobave në rastet kartel” (2006/C 298/11) si dhe Udhëzuesin e Komisionit Europian “Mbi metodologjinë e vendosjes së gjobave sipas nenit 23/2/a të rregullores nr 1/2003” (2006/C 210/02). Qëllimi kryesor i kësaj rregulloreje është zbatimi i një metodologjie të qartë dhe të përafruar me standardet evropiane gjatë procesit të llogaritjes së gjobës si dhe rastet kur një subjekt përfton imunitet nga gjobat. Gjithashtu, një rëndësi e veçantë i duhet dhënë bashkëpunimit me aktorët e tregut. Duke i cilësuar rastet e marrëveshjeve të ndaluara si një nga format e kufizimit të konkurrencës në treg, me pasoja shumë të dëmshme për konkurrencën, kjo rregullore paraqet rëndësi pasi përmban dispozita lidhur me lehtësimin nga gjobat në rastet e bashkëpunimit të ndërmarrjeve pjesë të këtyre marrëveshjeve me Autoritetin. Në këtë rast rregullorja ashtu si dhe neni 77 të Ligjit, garantojnë imunitet për këto ndërmarrje.

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr 121, datë 10.09.2009 ka miratuar rregulloren “Për marrëveshjet e rëndësisë së vogël” (De Minimis). Kjo rregullore ka synuar të përafrojë Njoftimin e Komisionit Europian “Mbi marrëveshjet me rëndësi të vogël të cilat nuk e kufizojnë konkurrencën sipas nenit 81/1 të Traktatit që ka themeluar Komunitetin Evropian” (de minimis). Kjo rregullore ka për qëllim të tregojë se cilat konsiderohen marrëveshje me rëndësi të vogël dhe pasojat e pa konsiderueshme që ato kanë mbi konkurrencën në treg dhe si të tilla nuk përfshihen në fushën e veprimit të nenit 4 të Ligjit të mësipërm. Në këtë rregullore janë përcaktuar: qëllimi i saj, klasifikimi i ndërmarrjeve duke respektuar dispozitat e ligjit mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, pjesët e tregut që duhet të zënë këto marrëveshje që të konsiderohen si të tilla, etj. Qëllimi kryesor i kësaj rregulloreje është vendosja e një kuadri rregullator duke ndihmuar dhe përjashtuar nga zbatimi i nenit 4 të Ligjit ato lloj marrëveshjesh të cilat nuk cenojnë konkurrencën dhe që i krijojnë mundësi ndërmarrjeve të vogla të mbijetojnë në lojën e tregut, por duke mbrojtur mirëqënien e konsumatorit final.

Komisioni i Konkurrencës me Vendimet nr 131 dhe 132 datë 07.12.2009 ka miratuar udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale” si dhe udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve vertikale”. Këto udhëzime në përgjithësi kanë karakter shpjegues dhe synojnë të japin një tablo të qartë se si Autoriteti vlerëson një përqendrim, në rastet kur ndërmarrjet pjesëmarrëse janë konkurrentë aktualë ose potencialë në të njëjtin treg përkatës, ose në tregje përkatëse të ndryshme. Ato paraqesin një kuadër analitik, në mbështetje të Autoritetit të Konkurrencës gjatë shqyrtimit të rasteve të përqendrimeve të njoftuara në kuptim të nenit 10 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Gjithashtu, në këto udhëzime jepen mjetet dhe rrugët për analizimin e efekteve të mundshme anti konkurrese dhe faktorët kundërveprues të tillë si fuqia blerëse, pengesat në hyrje dhe eficiencat e mundshme të paraqitura nga palët etj. Gjatë hartimit të tyre, është mbajtur parasysh që të mos ketë mbivendosje apo tejkalim të kompetencave të dispozitave të parashikuara në Ligj, si dhe të jenë në përputhje dhe plotësisht të përafruar me

Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale” dhe Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve jo-horizontale dhe konglomerate” të Komisionit Europian.

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr 115, datë 26.05.2009 ka miratuar disa shtesa dhe ndryshime duke amenduar rregulloren ekzistuese “Për funksionimin e AK-së”. Këto amendime synojnë të përmirësojnë mënyrën e funksionimit të grupeve të punës gjatë procedurave hetimore brenda Autoritetit të Konkurrencës, parashikojnë procedura të qarta lidhur me paraqitjen e raportit hetimor, mënyrat e pranimit dhe trajtimit të ankesave bazuar nga eksperiencia e vendeve të ndryshme anëtare të ICN-së, është parashikuar një formular tip për ankesat e të tretëve si dhe ruajtjen e anonimatit të personave që paraqesin ankesat, etj. Format i ankesës është paraqitur në websitin e Autoritetit të Konkurrencës.

Gjatë këtij viti janë hartuar shumë prej akteve ligjore dhe nënligjore që duheshin hartuar, por ka edhe iniciativa të tjera që mbeten për t’u realizuar në vitin e ardhshëm. Përmendim Udhëzimet “Për Vlerësimin e marrëveshjeve horizontale”, Udhëzimin “Për vlerësimin e marrëveshjeve vertikale”, të cilat janë në proces diskutimi brenda Autoritetit të Konkurrencës dhe që janë hartuar duke pasur parasysh Udhëzimet respektive të BE-së.

#### ***IV.4 Rishikimi gjyqësor i çështjeve të Autoritetit të Konkurrencës***

Gjatë vitit 2009 Autoriteti i Konkurrencës ka ndjekur me përpikmëri të gjitha procedurat e rishikimit të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës në të tre hallkat e sistemit gjyqësor. Përgjithësisht gjykatat në shqyrtimin e çështjeve të kufizimeve të konkurrencës kanë avancuar nga shqyrtimi i procedurës administrative në analizën e rasteve sipas praktikave europiane në fushën e konkurrencës. Tashëm ka vendime të Komisionit të Konkurrencës që janë analizuar nga gjykatat duke krijuar në këtë mënyrë shembujt e parë të së drejtës së konkurrencës në Shqipëri.

##### **IV.4.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është mbrojtur çështja civile me paditës “AMC” SHA e cila kërkonte shfuqizimin e Vendimit Nr. 7 datë 09.11.2008 të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Për hapjen e hetimit paraprak mbi abuzimin ose jo me pozitën dominuese të Altelekom SHA, Vodafone Albania SHA dhe AMC SHA”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin Nr. 784 datë 05. 02. 2009 vendosi për pushimin e gjykimit të kësaj çështjeje.

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është mbrojtur çështja civile me paditës ndërmarrjen “AMC” SHA e cila kërkonte shfuqizimin e Vendimit Nr. 59 të Komisionit të Konkurrencës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin Nr. 172 datë 19. 01. 2009 vendosi për rrëzimin e kërkesë padisë duke lënë kështu në fuqi vendimin e Komisionit të Konkurrencës. Aktualisht ndërmarrja “AMC” SHA e ka ankimuar

vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe jemi në pritje të shqyrtimit të kësaj ankese pranë kësaj gjykate.

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është mbrojtur çështja civile me paditës ndërmarrjen “VODAFONE ALBANIA” SHA e cila kërkonte shfuqizimin e Vendimit Nr. 59 të Komisionit të Konkurrencës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin Nr. 6026 datë 06. 07. 2009 të saj vendosi për rrëzimin e kërkesë padisë duke lënë kështu në fuqi Vendimin e Komisionit të Konkurrencës. Aktualisht ndërmarrja “VODAFONE ALBANIA” SHA e ka ankimuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe jemi në pritje të shqyrtimit të kësaj ankese pranë kësaj gjykate.

Aktualisht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, janë ankuar ndërmarrja “BLOJA” SHA dhe “ATLAS” SHA , të cilët kërkojnë shfuqizimin e vendimit Nr. 125 të Komisionit të Konkurrencës, për vendosje gjobe për pjesëmarrje në një marrëveshje të ndaluar në kuptim të nenit 4 të Ligjit. Shqyrtimi i këtyre çështjeve filloi në muajin dhjetor 2009 dhe aktualisht po vazhdon po pranë kësaj gjykate.

#### **IV.4.2 Gjykata e Apelit Tiranë**

Siç është paraqitur dhe në raportin e vitit 2008, tre ndërmarrje që ushtronin veprimtari në tregun e prodhimit të betonit kundërshtuan Vendimin Nr. 66 datë 18. 12. 2007 të Komisionit të Konkurrencës, duke kërkuar shfuqizimin e tij. Për dy ndërmarrje Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2008 kishte vendosur rrëzimin e kërkesave dhe për një të tjetrën, pushimin e gjykimit. Dy ndërmarrje, “Alban Tirana Co” SHPK dhe “Shkodra Beton” SHA, këto vendime i ankimuan pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Në vitin 2009 Gjykata e Apelit zhvilloi seancat gjyqësore nga ku për ankimin e ndërmarrjes “Shkodra Beton “ SHA me vendimin Nr. 237 datë 24. 02. 2009 vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe për ankimin e ndërmarrjes “Alban Tirana Co” SHPK me Vendimin Nr. 1113 datë 01.10.2009 vendosi pushimin e gjykimit në apel. Pra dhe Gjykata e Apelit Tiranë, pas shqyrtimit të ankesave të ndërmarrjeve të mësipërme, i ka konsideruar të ligjshme vendimet e Autoritetit të Konkurrencës

Ndërmarrja “ProCredit Holding” kishte ankimuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. Gjykata e Apelit Tiranë me Vendimin Nr. 1278 datë 20. 10. 2009 vendosi për lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke lënë në fuqi kështu Vendimin Nr. 63 datë 03.12.2007 të Komisionit të Konkurrencës “Për vendosjen e gjobës ndaj shoqërisë Procredit Holding AG”

Pranë Gjykatës së Apelit Tiranë u zhvillua dhe çështja civile ku shoqëritë e sigurimit kishin ankimuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila kishte vendosur rrëzimin e padisë duke lënë në fuqi vendimin Nr. 50 datë 21. 03. 2007 të Komisionit të Konkurrencës “Për vendosje gjobe ndaj shoqërive që veprojnë në tregun e sigurimit të detyrueshëm për produktin Policë Kufitare”. Mbi bazën e ankimit të tyre Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin Nr. 874 datë 29. 06. 2009 vendosi për

ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke pranuar kërkesë padinë. Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs , dhe aktualisht jemi në pritje të ditës së zhvillimit të seancës gjyqësore pranë Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2009 ka realizuar dhe vlerësime të akteve normative në zbatim të detyrimeve që dalin nga Ligji Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Në këtë kuadër, janë dhënë kontributet në vlerësimin e shkallës së shtrembërimit dhe/ ose kufizimit të konkurrencës, që rrjedh nga projekt – aktet ligjore e nënligjore për të cilat është kërkuar mendim pranë tij, ose dhe në rastet kur nga ana e vetë institucionit me nismën e tij, janë konstatuar shtrembërime, ose pengime të konkurrencës në akte të ndryshme normative.

#### **IV.4.3 Gjykata e Lartë**

Pranë Gjykatës së Lartë janë depozituar rekursat për tre vendime të Komisionit dhe gjatë vitit 2009 nuk ka filluar asnjë çështje.

Në mënyrë më të detajuar informacioni mbi statusin e vendimeve të Komisionit të Konkurrencës të ankimuar në gjykata të niveleve të ndryshme janë paraqitur në shtojcën Nr.2 bashkangjitur këtij raporti.

## **V. Kultura e konkurrencës**

Gjatë vitit 2009, Autoriteti ka bërë përpjekje për implementimin e një politike aktive për rritjen e kulturës së konkurrencës e cila vazhdon të mbetet e ulët dhe që përbën edhe një nga sfidat e Autoritetit të Konkurrencës. Ky fakt është i shprehur qartë edhe në raportin e progresit të Komisionit Europian.

Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit të biznesit, konsumatorëve, institucioneve publike, sistemit gjyqësor dhe publikut në përgjithësi lidhur me rëndësinë dhe rolin e politikës së konkurrencës është realizuar nëpërmjet një sërë tryezash diskutimesh. Kështu, draftet e amendimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe rregulloret janë diskutuar në tryeza të rrumbullakta me palët e interesit duke synuar tërheqjen e opinionëve si dhe nxitjen e ndjeshmërisë së tyre ndaj aktivitetit të institucionit të konkurrencës.

Marrëdhëniet me publikun, komunikimi me të, rritja e transparencës, dhe rritja e kulturës së konkurrencës mbeten prioritet në vazhdim të AK-së, në përmbushje të qëllimit të ligjit: Mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Nëpërmjet vënies në dispozicion të informacioneve dhe publikimeve të Autoritetit, intervistave dhe konferencave të shtypit dhe një faqe interneti interaktive të përditësuar, duke hedhur informacione të reja lidhur me veprimtarinë e Autoritetit dhe vendimet e Komisionit të Konkurrencës, është mundësuar një interes në rritje e mediave të cilat e konsultojnë vazhdimisht website-in e institucionit të konkurrencës.

Aktiviteti i Autoritetit të Konkurrencës për rritjen e kulturës së konkurrencës gjatë vitin 2009, në procesin e avokatisë së konkurrencës, u përqendrua kryesisht në transparencën e plotë të procedurave të ndjekura nga Autoriteti si dhe organizimi me seriozitetin e duhur të seancave dëgjimore, jo vetëm për palët në hetim, por edhe ftesa për gjithë palët e interesuara për proceset e shit/blerjeve dhe të përqendrimeve, brenda kuadrit ligjor.

Kjo transparencë është respektuar dhe nëpërmjet publikimit të vendimeve të Komisionit, në kohë reale, si dhe dëgjimi i aktorëve të tjerë (institucione shtetërore) përpara dhënies së rekomandimeve. Gjithashtu kjo transparencë është realizuar edhe nëpërmjet pjesëmarrjes publike në media, e cila ka shërbyer dhe për rritjen e kulturës së konkurrencës në Shqipëri. Autoriteti i konsideron palët e treta dhe biznesin bashkëpunëtor dhe i ka ftuar në çdo veprimtari të organizuar prej tij.

Përveç faqes aktive të internetit, Autoriteti i Konkurrencës ka praktikuar edhe forma të reja me anë të të cilave komunikon me biznesin të tilla si: broshurat të cilat përmbajnë informacion lidhur me legjislacionin dhe aktivitetin në fushën e konkurrencës (Përmendim "E drejta e konkurrencës dhe mbrojtja e konsumatorit").

Publikime të ndryshme kanë vijuar edhe këtë vit, të cilat përmbajnë informacion në lidhje me veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës. Përmendim Raportin Vjetor 2008 dhe synimet për vitin 2009, Buletinin Zyrtar të Vendimeve nr. 4, etj.

Organizimi i Ditës Kombëtare të Konkurrencës si një aktivitet kombëtar dhe ndërkombëtar, morri interesin jo vetëm të institucioneve qeveritare dhe enteve rregullatore, por edhe të studiove ligjore dhe të universiteteve, të cilët ishin pjesmarrës aktiv me punimet e tyre duke realizuar trajtime teorike dhe praktike të aspekteve të konkurrencës në vendet me ekonomi të vogël.



## **VI. Bashkëpunimi me institucionet, entet rregullatorë dhe organizmat ndërkombëtare**

Autoriteti i Konkurrencës e konsideron si shumë të rëndësishme bashkëpunimin me institucionet publike dhe entet rregullatore pasi në tërësinë e tyre këto institucione ndikojnë në nxitjen apo kufizimin e konkurrencës midis operatorve të tregut. Në këtë këndvështrim, institucioni i konkurrencës ka bashkëpunuar ngushtësisht me entet rregullatorë dhe institucionet e tjera të lidhura me rregullimin dhe/ose funksionimin e tregjeve specifike. Kryesisht vlerësimet e kuadrit ligjor dhe rregullator dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse në rastet e kufizimit të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg janë ndërmarrë me nismën e vetë Autoritetit të Konkurrencës.

### ***VI.1. Bashkëpunimi me entet rregullatorë dhe institucionet e tjera publike***

Autoriteti i Konkurrencës gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tij bashkëpunon me institucione të ndryshme publike, në lidhje me çështje që synojnë mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Bazuar në Ligjin nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” organet e administratës qendrore dhe entet rregullatorë kanë detyrimin për të shkëmbyer informacion dhe të dhëna në lidhje me qëllimin për të cilin kërkohen.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar bashkëpunimit me institucionet rregullatorë kompetente në fusha të caktuara të ashtuquajtur sektorë rregullatorë. AK ka bashkëpunuar ngushtësisht edhe këtë vit me Bankën e Shqipërisë, Entin Rregullator të Energjisë, Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare etj, nëpërmjet të cilëve është siguruar informacioni dhe të dhënat e nevojshme për rastet hetimore të nisura nga AK.

Duke e konsideruar të rëndësishëm këtë bashkëpunim me institucionet qendrore, vendore dhe përfaqësues të biznesit, Autoriteti i Konkurrencës, ka nënshkruar disa memorandume mirëkuptimi. Janë nënshkruar memorandume mirëkuptimi midis: Autoritetit të Konkurrencës dhe Autoritetit Hungarez të Konkurrencës, Autoritetit të Konkurrencës dhe Universitetit Evropian të Tiranës, Autoritetit të Konkurrencës dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Autoritetit të Konkurrencës dhe Komisionit të Konkurrencës së Kosovës. Në kuadër të nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit midis AK dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, palët nënshkruese të këtyre memorandumeve bien dakord të bashkëpunojnë në fushën e mbrojtjes së konkurrencës me qëllim promovimin dhe shkëmbimin e informacionit duke synuar zhvillimin e konkurrencës në treg me qëllimin final përfitimet e konsumatorëve si pasojë e një konkurrencë të lirë në treg.

Autoriteti i Konkurrencës ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me Komisionin e Konkurrencës së Kosovës. Nëpërmjet këtij memorandumi dy institucionet shprehin

vullnetin të bashkëpunojnë në fushën e konkurrencës, legjislacionit respektiv dhe politikës së konkurrencës, duke synuar krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e lidhjeve dypalëshe. Ky Memorandum synon të forcojë bashkëpunimin ndërmjet palëve në fushën dhe politikën e konkurrencës, si për sa i përket çështjeve të përgjithshme të konkurrencës, ashtu edhe rasteve individuale; palët angazhohen të shkëmbejnë informacion në kryerjen e hetimeve për sa i përket sjelljeve anti konkurrese dhe shkelje të tjera të ligjit të konkurrencës; angazhohen t'i mundësojnë secilës palë raportet vjetore, përshkrime të rasteve, studime mbi politikën e konkurrencës dhe materiale të tjera të përshtatshme mbi legjislacionin e konkurrencës, etj.

Në kuadër të Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) dhe përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin për përafrimin e legjislacionit, Autoriteti i Konkurrencës ka bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Integritimit në funksion të plotësimit të këtyre angazhimeve. Në këtë mënyrë kuadri i ri ligjor dytësor në fushën e konkurrencës i miratuar gjatë vitit 2009 reflekton në masë të madhe kërkesat e direktivave europiane në fushën e konkurrencës.

## ***VI.2 Bashkëpunimi me Bashkimin European (dhe TAIEK)***

Autoriteti i Konkurrencës ka respektuar afatet kohore lidhur me raportimet dhe progreset e bëra në periudha të caktuara kohore, duke pasqyruar nismat ligjore, aktivitetet zbatuese në kuadër të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg si dhe rritjen e kapaciteteve administrative me synim rritjen e profesionalizmit të stafit. Në kuadër të këtyre raportimeve, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë pjesë në takimin e Grupit të Punës për çështjet e Tregut të Brendshëm dhe Konkurrencën duke siguruar zbatimin nga ana e AK-së të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit si dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet Bashkimit European dhe Republikës së Shqipërisë. Komisioni European në raportin e tij është shprehur se Shqipëria në fushën e konkurrencës ka bërë progres të mirë, duke nënvizuar progresin e institucionit të konkurrencës në aspekte të ndryshme.

Fusha e konkurrencës është gjithashtu një kapitull i veçantë i pyetësorit të BE-së, (Kapitulli 8 "Politika e Konkurrencës") dhe konkurrenca është faktor i rëndësishëm në krijimin dhe funksionimin e tregut të përbashkët në Komunitetin European. Autoriteti i Konkurrencës i ka kushtuar rëndësi të veçantë plotësimit të këtij pyetësori duke respektuar afatet kohore dhe përgatitjes me cilësi dhe vërtetësi të çdo pyetjeje drejtuar këtij institucioni. Për më tepër, duke qënë në pozicionin e kordinatorit për kapitullin 8 të pyetësorit, iu mundësua një lidhje ndër-institucionale me ministrinë të cilat kishin dhënë të drejtat ekskluzive duke i ndërgjegjësuar mbi domosdoshmërinë e bashkëpunimit paraprak para dhënies së këtyre llojeve të drejtash, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në mirë funksionimin e tregjeve.

Rëndësi i është kushtuar aktiviteteve në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, në lidhje me procesin e integritimit në BE, duke bashkëpunuar me Qendrën Rajonale të OECD-së (RCC) në Hungari, me Programin e TAIEX, me institucionet homologe, etj.

Programi TAIEX ka ndihmuar gjerësisht në rritjen e kualifikimeve të stafit të Autoritetit të Konkurrencës me praktikën dhe legjislacionin europian në fushën e konkurrencës. Nëpërmjet aplikimeve Autoriteti i Konkurrencës ka përfituar vizita ekspertesh dhe organizimin e workshopeve me eksperte ndërkombëtare. Anëtarë të stafit të Autoritetit të Konkurrencës kanë marrë pjesë në kurse intensive trajnimi, seminare dhe workshop-e për çështjet e konkurrencës.

Në datë 25 Mars 2009 Autoriteti i Konkurrencës me mbështetjen e TAIEX organizoi workshop-in në Tiranë “Zbatimi i Ligjit dhe Politikës së Konkurrencës në vendet me ekonomi të vogël si Shqipëria”. Në këtë workshop u prezantua eksperiencia shqiptare si dhe sollën eksperiencën e tyre ekspertë nga Malta, Lituania, Rumania dhe Estonia. Në këtë workshop morën pjesë përfaqësues të institucioneve të ndryshme publike të tilla si Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe ministri të tjera të linjës, Entet Rregullatorë të tilla si Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorëve, Përfaqësues të shumtë të studiove ligjore etj. Workshop-i ndihmoi në shkëmbimin e eksperiencës midis përfaqësuesve të autoriteteve homologe të konkurrencës.

Nga aplikimi pranë këtij programi, është miratuar gjithashtu organizimi i një workshop-i me temë “Analizat Statistike dhe Ekonometrike” në të cilin pritet përfaqësimi i një numri të madh specialistësh të organeve të administratës qendrore dhe vendore, të komunitetit të biznesit përveçse stafi i Autoritetit të Konkurrencës. Ky workshop pritet të organizohet në pranverën e 2010 ku ekspertë të BE-së do trajtojnë aspekte të ndryshme të kësaj teme.

### ***VI.3 Rrjeti rajonal i konkurrencës***

Si anëtarë e ICN-së, përfaqësues të AK-së përgjatë 2009 kanë marrë pjesë në Grupet e Punës së ICN-së, në konferencat e zhvilluara si dhe në telekonferencat e organizuara për konkurrencën. Anëtarë të stafit të AK-së kanë marrë pjesë aktive gjithashtu edhe në konferencat apo seminarët e organizuara nga autoritetet homologe të konkurrencës duke paraqitur eksperiencën shqiptare në këto evente. Bashkëpunimi dhe anëtarësimi në këtë rrjet lidhet pikërisht me shkëmbimin e përvojave me autoritetet e konkurrencës së vendeve të ndryshme, si dhe me hartimin dhe njësimin e standardeve dhe rregullave të konkurrencës.

Marrëdhëniet me donatorët vazhdojnë të jenë një faktor mbështetës, tepër i rëndësishëm në realizimin e projekteve strategjike të Autoritetit të Konkurrencës, me qëllim ngritjen institucionale.. Autoriteti i Konkurrencës ka bashkëpunuar ngushtësisht edhe gjatë vitit 2009 me GTZ, në projekte të ndryshme, organizimi workshopeve,

financime për publikime të ndryshme etj. Përmendim ndihmesën e GTZ në financimin e ekspertit në fushën e konkurrencës përgjatë hartimit të draft mendimeve të ligjit, apo spotin financiar për organizimin e Konferencës ndërkombëtare me rastin e 5-vjetorit të krijimit të institucionit të Autoritetit të Konkurrencës, spotin financiar për organizimin e seminarit në Korrik 2009 për draft amendimet e ligjit dhe për 2 projekt rregulloret e reja të AK-së, etj.

#### ***VI.4 Bashkëpunimi me qendrën rajonale OECD***

Qendra Rajonale e OECD-së (RCC) në Budapest, Hungari, ka organizuar seminare dhe trajnime në të cilat kanë marrë pjesë nëpunësit e Autoritetit të Konkurrencës. Trajnimet kanë pasur tema të ndryshme në fushën e konkurrencës dhe të implementimit të legjislacionit të konkurrencës. Autoriteti i Konkurrencës në bashkëpunim me Qendrën Rajonale për Konkurrencën e OECD në Budapest, organizuan në datat 15 – 17 Qershor 2009, në Durrës, një seminar rajonal për konkurrencën, fokusuar në marrëveshjet vertikale. Në këtë seminar morën pjesë përfaqësues të autoriteteve simotra nga vendet e Europës Juglindore dhe Republikat e ish – BS, si dhe ekspertë ndërkombëtare të kontraktuar nga RCC. Gjatë këtij seminari u shkëmbyen përvojat respektive nga panelistët dhe pjesëmarrësit në lidhje me përvojat dhe praktikat për marrëveshjet vertikale.

Në vijim të këtij bashkëpunimi me RCC, përfaqësues të Autoritetit të Konkurrencës, kanë marrë pjesë në trajnimet dhe seminarat e zhvilluara në Budapest, të cilat përfshijnë aspekte që kanë të bëjnë me kontrollin e përqendrimeve, abuzimin me pozitën dominuese dhe fiksimin e çmimeve në rastet e karteleve. Përfaqësuesit e AK-së në këto seminare kanë paraqitur rastet e tyre nga përvoja e Autoritetit të Konkurrencës.

## VII. Realizimi i buxhetit të Autoritetit të Konkurrencës

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2009 ka zbatuar me korrektësi kërkesat e Ligjit nr 10025, datë 27.11.2008 “ Për buxhetin e shtetit të vitit 2009” në lidhje me përdorimin e fondeve buxhetore si dhe ka përgatitur buxhetin afatmesëm 2010-2012 për Autoritetin e Konkurrencës.

Treguesit buxhetorë të vitit 2009 (në 000 lek)

Nr	E m ë r t i m i	Plan	Fakt	Diferenca	Realizimi(%)
1.	<b>Paga</b> dhe sigurime shoqëore	46 085	43157	2 900	93
2.	<b>Materiale dhe shërbime të përgjithëshme</b>	14.000	13 565	434	96
3.	<b>Investime</b>	3.000	1 579	1 420	52
<b>TOTALI</b>		<b>63 625</b>	<b>58 662</b>	<b>4782</b>	<b>92</b>

Të dhënat financiare tregojnë një realizim prej 92.3%. Mosrealizimi në zërat e mësipërm ka ardhur kryesisht për shkak se:

- a. në zërin paga dhe sigurime shoqërore ka ardhur kryesisht nga mungesa e një anetari të Komisionit të Konkurrencës për rreth 6 muaj dhe kalimi i pagave të muajit dhjetor në muajin janar 2010.
- b. në zërin investime mosrealizimi ka ardhur për shkak të mosrealizimit të procedurave të prokurimit “Blerje paisje informatike” për mungesë ofertash.

### Të ardhurat e siguruara nga Autoriteti i Konkurrencës

Në zbatim të nenit 31/2 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ardhurat e Autoritetit të Konkurrencës nga kontrolli i përqëndrimeve dhe gjobat e vendosura derdhen në buxhetin e shtetit. Autoriteti i Konkurrencës ka derdhur 3.6 milionë lekë në buxhetin e shtetit nga kontrolli i përqëndrimeve gjatë vitit 2009, ndërkohë që totali i gjobave të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës për periudhën 2004-2009 është 790,576,410 lekë (për më shumë detaje shih shtojcën 2).

## **VIII. Synimet kryesore të punës për vitin 2010**

Autoriteti i Konkurrencës duke marrë në konsideratë eksperiencat e përfituara nga zbatimi i ligjit dhe duke synuar konsolidimin institucional në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira të rritjes ndërkombëtare të konkurrencës, për vitin 2010 do të fokusohet kryesisht në: rritjen e advokacisë së konkurrencës duke forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional; rritjen e kulturës për ligjin dhe politikën kombëtare të konkurrencës duke promovuar partnerhipin dhe bashkëpunimin me komunitetin e biznesit; si dhe përsosjen e teknikave investigative duke rritur profesionalizmin dhe ekspertizën e stafit teknik të Autoritetit. Këto drejtime ndikojnë ndjeshëm në konsolidimin e mëtejshëm të Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës.

### ***VIII.1 Forcimi i advokatisë dhe i kulturës të konkurrencës***

Advokacia e konkurrencës është jo vetëm një nga shtyllat e ligjit, por përbën një domosdoshmëri jetike për një efekt real të aktivitetit të Autoritetit të Konkurrencës për një treg funksional. Në funksion të rritjes së advokatisë së ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, janë planifikuar disa workshope dhe seminare trajnimesh me ekspertë ndërkombëtarë të financuar nga TAIEX-i, ku përveç stafit të Autoritetit të Konkurrencës do të ftohen për të marrë pjesë edhe përfaqësues të organeve të ndryshme administrative, enteve rregullatore, studiove ligjore, pushtetit gjyqësor etj.

Veprimtaria efektive e Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të Politikës dhe Ligjit për konkurrencën, ndikohet nga perceptimi dhe reagimi i të gjithë aktorëve të tregut, që preken nga kjo veprimtari. Për këtë arsye nxitja e kulturës dhe advokatisë së konkurrencës do të mbetet një nga prioritetet kryesore e punës së Autoritetit. Në këtë kuadër, Autoriteti i Konkurrencës do të vazhdojë bashkëpunimin me komunitetin e biznesit si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal. Gjithashtu Autoriteti i Konkurrencës do të rrisë bashkëpunimin me dhomat e tregtisë që grupojnë biznese të huaja dhe vendase si Dhoma Amerikane e Tregtisë, Dhoma Gjermane e Tregtisë, Dhoma Angleze e Tregtisë etj.

Edhe gjatë vitit 2010 do të vazhdojë konsultimi me aktorët e tregut, si institucionet publike dhe rregullatore, studiot ligjore dhe përfaqësuesit e sistemit të drejtësisë, komunitetin e biznesit dhe përfaqësuesit e qeverisë qendrore dhe vendore në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor në fushën e konkurrencës si amendamentet e ligjit apo miratimi i rregulloreve të reja.

Autoriteti i Konkurrencës do të synojë që të rritet bashkëpunimi me mediat, si në drejtim të pasqyrimin të veprimtarisë së Autoritetit, por edhe në drejtim të partneritetit të përfshirjes së mediave në diskutimin e çështjeve të rëndësishme të veçantë për politikën e ligjit të konkurrencës, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe të vetë gazetarëve për këto çështje.

Bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë me qëllim nxitjen e studimit të konkurrencës si në aspektin juridik ashtu edhe atë ekonomik, si dhe përfshirjen e studentëve në punën e Autoritetit të Konkurrencës në drejtim të kryerjes së

internshipeve dhe/ ose praktikave mësimore, duke përdorur këto potenciale për realizimin e pytesoreve për stundimet e tregut.

### ***VIII.2. Forcimi i kapaciteteve administrative***

Pa dyshim që ngritja e një kulture të konkurrencës është një proces i gjatë e i vështirë, por është i domosdoshëm për një përmirësim të zbatimit të ligjit dhe politikës së konkurrencës. Në këtë drejtim, Autoriteti i Konkurrencës po mendon në planin afatmesëm ngritjen e një strukture të veçantë brenda tij që të fokusohet në çështjet e avokatësisë së kulturës së konkurrencës. Ky model është ndjekur nga shumë autoritete të konkurrencës në vende të zhvilluara, por edhe në vende të rajonit. Një strukturë e tillë është veçanërisht e domosdoshme në vende të tilla si Shqipëria ku ka një kulturë të pazhvilluar në fushën e konkurrencës në veçanti por edhe në drejtim të kulturës ligjore në përgjithësi.

Autoriteti i Konkurrencës në vitin 2010 do të synojë të forcojë kapacitetet institucionale në drejtim të konsolidimit dhe përsosjes së teknikave investigative dhe rritjen e shkallës së ekspertizës me qëllim uljen e kohës së realizimit të hetimeve. Në këtë funksion do të ndihmojë ndjeshëm financimi që do të mundësohet nga IPA-2008, e cila pritet të fillojë si në nivel të asistencës teknike ashtu edhe nepermjet projektit të binjakëzimit, nëpërmjet të cilit është kërkuar që të konsiderohen organizimi i intershipeve të stafit teknik të Autoritetit në mjediset e punës së autoriteteve homologe partnere në këtë projekt.

Buxheti i vitit 2010 për herë të parë është projektuar i ndarë në dy programe, (i) mbikqyrja e tregut, garantimi i konkurrencës dhe (ii) planifikim, menaxhim, administrimi, që të ndara në projekte do të sigurojnë një përdorim eficient të burimeve financiare të detajuar sipas qëndrave të kostos për çdo procedurë hetimore që do të ndërmerret Autoriteti i Konkurrencës. Ky sistem do të mundësojë matjen në mënyrë më të drejtpërdrejtë të performancës së gjithësecilit dhe rritjen e shkallës së përgjegjshmërisë.

### ***VIII.3. Monitorimi i tregjeve dhe hetimi i praktikave të mundshme antikonkurrese***

Fillimi i vitit 2010 e gjeti institucionin e konkurrencës duke monitoruar dhe hetuar mbi praktikat potenciale antikonkurrese në disa sektorë dhe tregje specifike, të cilat kanë filluar gjatë vitit të kaluar. Kështu, monitorimi i tregut të shërbimeve bankare me pakicë ka nisur në fund të vitit 2009 dhe do të vazhdojë në tremujorin e parë të vitit 2010, mbështetet në shqetësimet e Kuvendit dhe publikut nëpërmjet medias mbi komisionet bankare që aplikojnë bankat dhe shërbimet e tjera. Për monitorimin e këtij tregu është ndjekur metodologjia e Komisionit Europian për raste të ngjashme të sektorit bankar.; Hetim i thelluar në tregun e prokurimit të makinave do të përfundojë brenda gjysmës së parë të vitit 2010. Mbështetur në praktikat më të mira të OECD-së, Autoriteti i Konkurrencës do të organizojë një seri trajnimesh për administratën e ngarkuar me procedurat hetimore për ndërgjegjësimin e tyre me rastet e

“marrëveshjeve të ndaluara” mes konkurrentëve në prokurimet publike si dhe sinjalizimin e Autoritetit të Konkurrencës për rastet e dyshuara.

Aktualisht, është hapur hetimi paraprak në tregun e gazit, për shkak të ndryshimeve strukturore në segmentin e tregut të shkarkimit dhe depozitimit të cilat i kanë dhënë pozitë dominuese disa operatorëve dhe për këtë arsye do të hetohet nëse ka shkelje të nenit 9 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, abuzim me pozitën dominuese.

Në tregjet me pozitë dominuese do të vazhdojë monitorimi, si në sektorin e energjisë elektrike dhe hetimi i thelluar në tregun e hidrokarbureve (nafta D2) për ndërmarrjen ARMO, edhe tregu i komunikimeve elektronike. Gjithashtu, krahas perfundimit të monitorimeve që janë në proces, transporti dhe shërbimet aeroportuale të TIA (transporti publik, transporti ajror) do të jenë nën monitorim për të parë kushtet e funksionimit të tregut, si dhe monitorimin e tregjeve të tjera sipas dyshimeve për shkelje të mundshme të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

#### ***VIII.4. Konsolidimi i profilit të bashkëpunimit të AK me partnerët ndërkombëtare***

Autoriteti i Konkurrencës edhe gjatë vitit 2010 është ftuar për të qënë partner në manaxhimin e aktiviteteve ndërkombëtare të konkurrencës të organizuara nga OECD-ja si në Forumin Global të Konkurrencës (Paris, Shkurt 2010) apo nga Qendra Rajonale e Konkurrencës OECD (Budapest, 2010). Këto përbëjnë një risi që ka për bazë punën disa vjeçare të Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës, për të paraqitur profilin e vet si një institucion bashkohor i konkurrencës me partnerët ndërkombëtarë. Përgjegjësia e këtij institucioni është konsolidimi i këtij profili edhe gjatë periudhës së ardhëshme.

Një aspekt tjetër i bashkëpunimit me partneret europianë është vendosja në efikasitet të financimit që do të realizohet nëpërmjet IPA-2008 për asistencë teknike dhe nëpërmjet programit të binjakëzimit me Autoritetin Italian , dhe Hungarez të Konkurrencës (të cilat janë fitues të tenderit të realizuar nga delegacioni i BE-së në Tiranë).



**Shtojcë 1. Të dhëna statistikore mbi vendimet e Komisionit të Konkurrencës sipas viteve**

Viti	Vendimet ne Total	Vendimet per Perqendrime t	Vendimet per Abuzimin me Poziten Dominuese	Vendimet per Marrveshjet e ndaluara	Vendimet Per Perjashtime nga Marrveshjet	Vendime per Rregullore dhe Udhezues	Vendime per Rekomandime ndaj Institucioneve Publike	Vendime per vendosje Gjobe	Vendime Te tjera
<b>2004</b>	13	2				6	1	-	4
<b>2005</b>	17	-				2	3	1	11
<b>2006</b>	14	4				-	1	1	8
<b>2007</b>	25	9	1	3		4	2	5	2
<b>2008</b>	29	11	1		1	4	5	-	7
<b>2009</b>	36	8	1	2	1	2	10	2	10
<b>Totali</b>	135	35	3	5	2	18	22	9	42

**Shtojcë 2: Vendimet administrative(gjobat) e vendosura nga Komisioni i Konkurrencës**

<b>VENDIMET PER GJOBA TE KOMISIONIT TE KONKURRENCES</b>							
<b>Nr.</b>	<b>Data</b>	<b>Ndërmarrjet</b>	<b>Përqindje xhiros</b>	<b>Shuma(lek)</b>	<b>Konfirmuar/Rezuar</b>	<b>Shkalla gjyqesorit</b>	<b>Ekzekutimi nga Tatimet</b>
27	12.12.2005	AMC	1	160.000.000	konf,Shk,I,,Apeli,-rigjykim	gjykate,e,larte	e,paekzekutuar
38	16.05.2006	ÇALIK,HOLD(BKT)		6.549.476	konf,shk,I,,konf,shk,II	gjykate,e,larte	e,paekzekutuar
50	21.03.2007	SIGMA	2	15.170.870	konfirmuar,shkall,I,,rrezuar,shkalla,II	gjykate,e,larte	e,paekzekutuar
		SIGAL	2	21.768.394	konfirmuar,shkall,I,,rrezuar,shkalla,II	gjykate,e,larte	e,paekzekutuar
		INSIG	2	28.151.049	konfirmuar,shkall,I,,rrezuar,shkalla,II	gjykate,e,larte	e,paekzekutuar
		EUROSIG	2	1.654.026	konfirmuar,shkall,I,,rrezuar,shkalla,II	gjykate,e,larte	e,paekzekutuar
		ATLANTIK	2	8.207.318	konfirmuar,shkall,I,,rrezuar,shkalla,II	gjykate,e,larte	e,paekzekutuar
		INTERSIG	2	6.969.233	konfirmuar,shkall,I,,rrezuar,shkalla,II	gjykate,e,larte	e,paekzekutuar
		INTERALBANIAN	2	5.008.708	konfirmuar,shkall,I,,rrezuar,shkalla,II	gjykate,e,larte	e,paekzekutuar
		ALBSIG	2	3.900.773	konfirmuar,shkall,I,,rrezuar,shkalla,II	gjykate,e,larte	e,paekzekutuar
59	09.11.2007	AMC	2	211.552.000	fituar,shkalla,e,pare	Apel	e,paekzekutuar
		VODAFONE	2	242.633.000	fituar,shkalla,e,pare	Apel	e,paekzekutuar
63	3.12.2007	PROCREDIT		7.237.464	fituar,shkalla,I	Apel	e,paekzekutuar
66	18.12.2007	ALBAN,TIRANA		447.915	konfirmuar,shk,I	Apel	e,paekzekutuar
		BEST,CONSTRUCT		235.367	u,pushua,nga,gjykata	forme,e,prere	e,paekzekutuar
		BETON,EXPRESS		178.534	e,pa-apeluar	forme,e,prere	e,paekzekutuar
		FERRO,BETON		436.959	e,paapeluar	forme,e,prere	e,paekzekutuar
		HALILI,		172.519	e,paapeluar	forme,e,prere	e,paekzekutuar
		ITAL-BETON		201.086	e,paapeluar	forme,e,prere	e,paekzekutuar
		KIRCHBEGER		508.279	e,paapeluar	forme,e,prere	e,paekzekutuar
		QARRI-02		169.652	e,paapeluar	forme,e,prere	e,paekzekutuar
		SHKODRA,BETON		396.974	konfirmuar,ne,Shk,I,,shkalle,e,dyte	forme,e,prere	e,paekzekutuar
67	24.12.2007	KAJO,HALLKA		30.000	e,paapeluar	forme,e,prere	e,paekzekutuar
123	18.09.2009	Albania,Airlines,MAK,shpk		2.600.000	pa,apeluar		
125	08.10.2009	Bloja,sha,		38.548.251		Gjykata,e,shkalles,se,pare,	
		Bloja,sha,		27.848.563		Gjykata,e,shkalles,se,pare	
		<b>Shuma totale e gjobave</b>		<b>790.576.410</b>			

### **Shtojcë 3: Matrica e vlerësimeve dhe rekomandimeve të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2009**

Nr.	Objekti:	Vlerësimi i Autoritetit të Konkurrencës	Sa është marrë në konsideratë
<b>1</b>	Vlerësimi i projekt –ligjin “Për auditimin ligjor të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”. <i>Me anë të shkresës Nr. 35/1 datë 03. 02. 2009 Instituti Kombëtar i Auditëve i ka kërkuar Autoritetit të Konkurrencës vlerësimin e këtij projekt-ligji.</i>	Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Vendimit Nr. <b>102</b> , datë 17. 02. 2009 “Për Rekomandime ndaj Projekt – Ligjit “Për Auditimin Ligjor të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar”, vendosi: - Projekt – Ligji “Për auditimin ligjor të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar” nuk përmban shkallë të kufizimit apo pengimit të konkurrencës në lidhje me ushtrimin e profesioneve të lira, në kuptim të Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”;	.Pa rekomandim
<b>2.</b>	Raporti i Hetimit të Thelluar në Tregun e Sigurimeve për Produktin e sigurimit të detyrueshëm, TPL e Brendshme.	Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Vendimit Nr. <b>105</b> , datë 24.03.2009 “Për Disa rekomandime dhe masa për rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm TPL e brendshme”, vendosi, me shumicë votash: Ti rekomandojë Autoritetit Mbikqyrjes Financiare që: - Të njoftojë Autoritetin e Konkurrencës për çdo projekt akt normativ që mund të ketë pasoja mbi konkurrencën në treg. - Të kërkojë opinionin e Autoritetit për çdo ndryshim në lidhje me strukturën e tregut të sigurimeve, që mund të sjellë pasoja për konkurrencën.	
<b>3</b>	Vlerësim i Vendimit të Këshillit Administrativ të ISKSH-së Nr. 50, datë 12.12.2008 “Për miratimin e kontratave tip midis ISKSH, farmacive dhe agjencive farmaceutike, depove importuese, distributoreve të barnave si dhe kontratën trepalëshe ndërmjet ISKSH-së – QSUT-së – Depove të Barnave për vitin 2009” <i>Nisme: Ankesa Nr. 23/01, datë 23.01.2009 të Sindikatës së Pavarur të Farmacistëve të Rrjetit të Hapur.</i>	Autoriteti i Konkurrencës me anë të VKK nr. <b>109</b> , dt. 04.05.2009 “Për rekomandim mbi rishikimin e pikës 1 të Vendimit të Këshillit Administrativ të ISKSH-së nr. 50, dt. 12.12.2008”, vendosi, me shumicë votash: - T’i rekomandojë Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, rishikimin e pikës 1 të Vendimit të tij nr.50, datë 12.12.2008 “Për miratimin e kontratave tip midis ISKSH, Farmacive dhe Agjencive farmaceutike, depove importuese, distributore të barnave si dhe kontratën trepalëshe ndërmjet ISKSH-së – QSUT-së – Depove të Barnave për vitin 2009”;	Këshillit Administrativ i ISKSH-së me Vendimin nr. 112, dt. 15.12.2009 “Për miratimin e kontratave tip midis ISKSH, Farmacive dhe Agjencive farmaceutike, depove importuese, distributore të barnave si dhe kontratën trepalëshe ndërmjet ISKSH-së – QSUT-së – Depove të Barnave për vitin 2010” ka marrë parasysh rekomandimin e dhënë nga AK.

4	<p>Vlerësimi i Projekt-ligjit “Për ofertat publike të titujve”.  <i>Me anë të shkresës nr. 3387 Prot, datë 10.04.2009 Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës i kërkon Autoritetit të Konkurrencës vlerësimin e tij për projekt-ligjin “Për ofertat publike të titujve”.</i></p>	<p>Autoriteti i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. <b>110</b> datë 15. 05. 2009 “Për Një rekomandim mbi projekt-ligjin “Për ofertat publike të titujve”, vendosi:          - Ti rekomandojë METE të shtojë pas pikës 3 të nenit 7 “Dokumenti i ofertës” të projekt-ligjit “Për ofertat publike të titujve”, një dispozitë me përmbajtjen si vijon:  <i>“Kur nga përftimi i kontrollit që parashikohet të ndodhë si rezultat i publikimit të dokumentit të ofertës, mund të krijohet një përqendrim në kuptim të nenit 12, pika 1, të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ky përqendrim duhet të njoftohet në Autoritetin e Konkurrencës, për të marrë autorizim, sipas dispozitave përkatëse të këtij ligji.”</i></p>	
5.	<p>“Vlerësimi i ankesave të Shoqërive të Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike”.  <i>Në ankesat e tyre SHRSF-të pretendojnë së në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe kërkesave për kualifikim, është shkelur legjislacioni mbi prokurimin publik.</i></p>	<p>Autoriteti i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. <b>114</b>, datë 26.05.2009 “Për “Disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në prokurimin publik të Shërbimit të Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike”, vendosi:          1. T’i rekomandojë autoritetit kontraktor “Drejtorisë së Përgjithshme të Prokurimeve të Përqendruara” pranë Ministrisë së Brendshme, të rrisë numrin e loteve të kontratës publike me objekt “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me subjekte private të objekteve të Kryeministrisë, Ministrive dhe institucioneve në varësi të tyre” me qëllim mundësimin e paraqitjes së kërkesave të grupuara sipas madhësisë të krahasueshme të autoriteteve kontraktore me madhësinë e ofertave individuale nga operatorët ekonomikë. Në këtë mënyrë mundësohet rritja e konkurrencës midis operatorve që plotësojnë nivelet respektive të kërkesës.          2. T’i rekomandojë Agjencisë së Prokurimit Publik që në varësi të natyrës së kontratës që prokurohet, t’ju propozojë autoriteteve kontraktore ndarjen e kontratave në lote/nën-lote në mënyrë të tillë që të mundësohet një pjesëmarrje sa më e gjerë e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimeve publike duke siguruar një përdorim sa më të mirë të fondeve publike, nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë sipas madhësisë së ndërmarrjeve të vogla e të mesme në këto procedura, si dhe nxitjen e konkurrencës midis tyre.</p>	<p>APP me anë të shkresës nr. 6889/12 prot., dt. 18.06.2009 ka kërkuar rishikimin e Vendimit të KK nr. 114, dt. 26.05.2009.</p>
6.	<p>Vlerësimi i akteve ligjore dhe nënligjore që ndikojnë në nivelin e konkurrencës në tregun e karburanteve.</p>	<p>Autoriteti i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. <b>118</b> datë 29.05.2009 “Për disa rekomandime për aktet ligjore dhe nënligjore që ndikojnë në nivelin e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë të karburanteve”, vendosi, me shumicë votash:          I. T’i rekomandojë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë:          - <i>Ndryshimin e nenit 14, pika 3, të Ligjit 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin Transportimin dhe tregtimin e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre”, duke e formuluar si më poshtë:</i>  <i>“Shoqëritë e tregtimit më shumicë kanë të drejtë të kenë stacionet e tyre të shitjes së karburanteve, apo njësi të lëndëve djegëse. Në këtë rast atyre nuk ju lejohet që të vendosin çmime apo kushte të tjera tregtimi favorizuese ndaj këtyre stacioneve</i></p>	<p>Nuk janë marë në konsideratë.</p>

		<p>përkundrejt stacioneve të bardha”.</p> <p><i>Në nenin 15 pika 2 të Ligjit Nr. 8450 datë 24.02.1999, të shtohet fjalia:</i></p> <p>“Kontratat e furnizimit, ndalohen të përmbajnë kushte që përcaktojnë çmimet e shitjes me pakicë, vendosjen e çmimeve minimum, si dhe vendosjen e kushteve të tjera të tregtimit që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mund të çojnë në përcaktimin e çmimit. Kopje të këtyre kontratave i vihen në dispozicion Autoritetit të Konkurrencës, sa herë që kërkohen nga ky institucion.”</p> <p>- <i>Ndryshimin e nenit 40 të Kodit doganor të Republikës së Shqipërisë, duke e formuluar si më poshtë:</i></p> <p>“Dogana merr parasysh gjithmonë kursin zyrtar të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë, ditën e punës paraardhëse të procedurave të zhdoganimit”.</p> <p>II. T’i rekomandojë Ministrit të Financave të Republikës së Shqipërisë ndryshimin e pikës 9.4 të Udhëzimit Nr. 17, datë 13. 05. 2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”; duke vendosur një afat kohor, afat i cili të mundësojë realizimin e transparencës së çmimeve.</p>	
<p><b>7.</b></p>	<p>Shqyrtimin e dokumentit të AKEP “Analiza e Tregut Celular: Tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë i shërbimeve publike celulare” dhe dhënia e rekomandimeve.</p>	<p>Autoriteti i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. <b>124</b>, datë 23. 09. 2009 “Për disa rekomandime mbi dokumentin e AKEP “Analiza e Tregut Celular: Tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë i shërbimeve publike celulare”, vendosi:</p> <p><i>1. Ti rekomandojë AKEP:</i></p> <p>I. Aplikimin metodologjisë së rregullimit të tarifave jo vetëm për shërbimin me parapagesë por edhe për: shërbimin me kontrate; mesazhet elektronike (sms) dhe shërbime të tjera.</p> <p>II. Aplikimin e “<b>Metodologjisë së Rregullimit të Tarifave të Terminimit</b>” derisa tarifat e telefonisë celulare të jenë të krahasueshme me mesataren e tarifave që aplikohen në vendet e Bashkimit Europian.</p> <p>III. Dhënien e licencës së re, në Tregun e Telefonisë së Lëvizshme, ta shoqërojë me marrjen e të gjitha masat e nevojshme për ta bërë sa më shpejt efektiv operatorin e katërt me synim rritjen e konkurrencës në treg.</p> <p>IV. Lidhur me shqetësimin e AKEP se ka shenja të mungesës së konkurrencës në tregun e telefonisë celulare, Autoriteti i Konkurrencës kërkon që me miratimin e raportit përfundimtar nga ana e Këshillit Drejtues të AKEP që të gjithë elementët, provat dhe faktet që disponon Rregullatori, në mbështetje të nenit 61, pika 2 të ligjit “Për komunikimet elektronike”, t’ia përcjellë Autoritetit të Konkurrencës për monitorimin dhe hetimin në tregjet përkatëse.</p>	<p>Autoriteti i Konkurrencës është pjesëmarrës në grupë-pune për hartimin e ligjit të komunikimeve elektronike</p>

<p><b>8</b></p>	<p>Raporti i Hetimit të Thelluar në tregun e importit të grurit prodhimit dhe shitjes së miellit për prodhimin e bukës.</p>	<p>Autoriteti i Konkurrencës me anë të Vendimit <b>Nr.126</b>, dt.08.10.2009 “Për mbylljen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve që operojnë në tregun e importit të grurit, prodhimit dhe shitjes së miellit për prodhimin e bukës dhe rekomandimet përkatëse”, vendosi:</p> <p>2. T’i rekomandoje Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të rishikojë praktikën e çmimeve të referencës në tregun e importit të grurit, për efektet e mundshme që mund të sjellin në kufizimin e konkurrencës në treg.</p> <p>3. T’i rekomandojë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve që gjatë praktikave të rivlerësimeve të mbajë parasysh efektet që mund të sjellin në treg për konkurrencën.</p> <p>4. T’i rekomandojë Insitutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar që të sigurojë se pasqyrat financiare pasqyrojnë saktë dhe drejt gjëndjen pasurore dhe situatën financiare të ndërmarrjeve Atlas Sha dhe Bloja Sha, si dy ndërmarrje me fuqi të madhe në treg.</p>	
<p><b>9.</b></p>	<p>Shqyrtimin e dokumentit të AKEP “Analizë e tregut të telefonisë fikse: Tregjet me pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumicë të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjete fikse: Konsultim publik”</p>	<p>Autoriteti i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. <b>130</b>, dt. 23.11.2009 “Për disa rekomandime mbi dokumentin e AKEP “Analizë e tregut të telefonisë fikse: Tregjet me pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumicë të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjete fikse”, vendosi:</p> <p><i>I. Ti rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare(AKEP),</i></p> <p>1. Të vazhdojë aplikimin e “Metodologjisë së rregullimit të tarifave” derisa tarifa e thirrjeve kombëtare të jetë e krahasueshme (benchmark) me mesataren e tarifave që aplikohen në vendet rajonit dhe vendet anëtare të Bashkimit Evropian.</p> <p>2. Rregullimin e plotë të tarifave të aplikuara nga Albtelekom duke rritur tarifat që janë nën kosto dhe duke rritur tarifat që janë mbi mesataren e vendeve të rajonit duke i orientuar drejt kostos në mënyrë që të mundësohet një konkurrencë efektive mes operatorëve.</p> <p>3. Pas vlerësimit të kostove të Albtelekom në modelin BULRAIC, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare duhet të balancojë tarifat e Albtelekom dhe t’i orientojë drejt kostos. Kjo do të shmangte ofrimin e disa shërbimeve nën kosto që eliminojnë konkurrencën në treg dhe nga ana tjetër do të orientonte drejt çmimeve të drejta disa tarifa që janë te tepruara dhe disa herë më të larta se vendet e rajonit dhe/ose vendet anëtare të Bashkimit Evropian.</p> <p>II. Ti kërkojë AKEP që në bazë të nenit 70 të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe nenit 38 të ligjit “Për komunikimet elektronike” të vërë në dispozicion të Autoritetit të Konkurrencës, të gjithë dokumentet që zotëron lidhur me abuzimin e mundshëm me Pozitën Dominuese të Albtelekom Sh.A në tregun e telefonisë fikse, të përshkruar në dokument. Ky informacion do të mundësonte hapat e mëtejshme në zbatim të ligjin</p>	

		<p>“Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.</p>	
<p><b>10.</b></p>	<p>Dhënien e rekomandimeve për Entin Rregullator të Energjisë Elektrike lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Aplikimin e KESH Sh.a për çmimin e shitjes së energjisë elektrike të Furnizuesit Publik me Shumicë (KESH sh.a) për vitin 2010 dhe çmimin e shitjes së energjisë elektrike të KESH-Gen (KESH sha),</li> <li>- Aplikimin e OST Sh.a për tarifën e shërbimit të transmentimit të energjisë elektrike për vitin 2010,</li> <li>- Aplikimin e OSSH Sh.a për tarifën e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2010 nëpërmjet përdorimit të rrjetit të shpërndarjes.</li> </ul>	<p>Autoriteti i Konkurrencës me anë të Vendimit nr. <b>133</b>, dt. 14.12.2009 “Për disa rekomandime për Entin Rregullator të Energjisë në lidhje me aplikimin për tarifën e reja të energjisë elektrike për vitin 2010 nga KESH Sh.A, OST Sh.A dhe OSSH Sh.A”, vendosi:</p> <p>I. Tí rekomandojë ERE-së të sigurojë transparencën e nevojshme për Autoritetin e Konkurrencës, lidhur me informacione sa më të plota, më të sakta dhe në kohë, për të mundësuar një gjykim objektiv mbi sjelljen e operatorve me pozitë dominuese në tregjet përkatëse.</p> <p>II. Tí rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë Elektrike që:</p> <p>II.1. Lidhur me aplikimin e KESH Sh.A.:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Tarifa e gjenerimit për vitin 2010 të jetë e orientuar drejt kostos së gjenerimit dhe normës së kthimit të kapitalit.</li> <li>- Mbështetur në pikën 5.7, paragrafi i fundit të Modelit të Tregut të Energjisë, çdo fitim neto nga eksportet i KESH Sh.A i parashikuar për vitin 2010, duhet të kihet parasysh që të reflektohet në përfitim të klientëve tariforë.</li> </ul> <p>II.2. Lidhur me aplikimin e OST Sh.A,</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rritja e pritshme e tarifës së transmetimit të orientohet drejt kostos mesatare të ponderuar të trasmetimit të çdo kilovatorë energjie. Gjithashtu, mbështetur në Metodologjinë e Tarifave për OST-në, tarifën e këtij operatori të orientohen drejt kostos mesatare afatgjatë të sistemit të trasmetimit.</li> </ul> <p>II.3. Lidhur me aplikimin e OSSH- Sh.A:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbi propozimin e paraqitur në aplikimin e operatorit për heqjen e bllokut të parë të konsumit si një subvencion i fshehur për klientët familjarë, rekomandojmë që të rishikojë këtë propozim bazuar në parimin që tarifën duhet të motivojnë për përdorimin me efikasitet të energjisë elektrike nga përdoruesi fundor.</li> <li>- Mbi propozimin e OSSH-së për tarifën mesatare të ponderuar për konsumatorët tariforë, propozojmë që ERE të miratojë një tarifë në minimumin e lejueshëm nga Deklarata Rregullatore.</li> </ul>	

**Shtojcë 4: Raport progresi i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2009 (Konkurrenca)**

“Progres i mirë është arritur në fushën e konkurrencës. Sistemi i dëgjësive publike në procedimet antitrust është përmirësuar, dhe është krijuar një njësi për gjokat. Hetime dhe dëgjesa publike janë mbajtur për marrëveshjet që cenojnë konkurrencën në fushën e importit të grurit dhe prodhimit të miellit, si edhe në tregjet e karburanteve dhe sigurimeve. Autoriteti i Konkurrencës (AK) vazhdoi analizimin e rasteve të bashkimeve dhe blerjeve të ndërmarrjeve. Autoriteti realizoi një hetim në sektorin energjetik dhe atë bankar dhe në nëntor 2008 nxori rekomandimet për tregun energjetik. AK-ja paraqiti një apelim në Gjykatën e Lartë për shkak të përplasjes mes vendimeve të gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë në lidhje me gjokat ndaj dy shoqërive celulare për abuzim me pozitat dominuese.

Stafi i Autoritetit të Konkurrencës është trajnuar rreth tregjeve ekonomike, sektorit energjetik, kufizimet vertikale dhe legjislacionin për shoqëritë tregtare. AK-ja është treguar aktive në mbrojtjen e konkurrencës, në bashkëpunim me dhomat e tregtisë dhe industrisë. Shtatë ankime janë regjistruar në 4 muajt e parë të 2009 në fushën e telekomunikacioneve, farmaceutike dhe të prokurimit.

Ligji për Konkurrencën po rishikohet për ta përafëruar më shumë me standardet e BE-së. AK-ja po harton kuadrin rregullator për çështjet që lidhen me gjokat dhe lehtësimin prej tyre, marrëveshje de minimis, marrëveshje horizontale dhe vertikale dhe bashkimet, si edhe për procedurat e brendshme të hetimit. Megjithatë, nuk është miratuar legjislacion i ri”